

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5844
E shtunë, 3 gusht 2019
çmimi 0.40 €

Palmeri: Krijimi i qeverisë, sfida e tanishme për Kosovën

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

KRYETARI I KUVENDIT TË KOSOVËS, KADRI VESELI, MË 5 GUSHT KA THIRRUR MBLEDHJE TË KRYESISË, NË TË CILËN DO TË DISKUTOHET PËR THIRRJEN E SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME PËR SHPËRNDARJEN E LEGJISLATURËS SË VI

FAQE 4-5

Kuvendi në prag të shpërndarjes



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe shefi i koalicionit PAN, Kadri Veseli, të premten zyrtarisht kanë qartësuar situatën në të cilën ndodhet vendi pas dorëheqjes së Ramush Haradinajt nga posti i kryeministrit. Thaçi, ashtu siç e parasheh Kushtetuta, ka kërkuar nga koalicioni fitues që ta propozojë mandatarin e ri për kryeministër, ndërkohë Veseli e ka njoftuar presidentin se PAN-i nuk ka mandatar tjetër. Kryeparlamentari Kadri Veseli ka bërë me dije se për të hënën ka thirrur mbledhjen e kryesisë së Kuvendit për të diskutuar rreth shpërndarjes së këtij institucioni. Sipas tij, tani zgjedhjet e parakohshme janë e vetmja alternativë



HARADINAJ BËN HOMAZHE TE LAPIDARI I KOMANDANT 'ROKIT' F. 6

NJË PERSON NË GJENDJE TË RËNDË NGA ETHET E MINJVE, MJEKËT APELOJNË PËR KUJDES F. 5

KTHIMI I QYTETARËVE NGA SIRIA E BËRI KOSOVËN REFERENCË GLOBALE KUNDËR TERRORIZMIT F. 3

EKONOMI

LLUKA: NGA VITI 2020 KOSOVA DO T'I KONTROLLOJË KUFIJTË E VET ENERGETIKË F. 8-9

LV-JA DORËZON KALLËZIM PENAL PËR ISH-MINISTRAT E BUJQËSISË F. 9

KULTURË

KRYEQYTETI DO TË BËHET ME SUNNY HILL ACADEMY F. 10



SPORT

FERONIKELI SHKARKON RAMADANIN, SOKOLI NË OPSION F. 16

LDK-ja, pa kandidat konsensual për kryetar

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) as të premten nuk ka arritur ndonjë marrëveshje për një kandidat konsensual për kryetar të partisë. Nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, pas mbledhjes së kryesisë ka bërë me dije se nuk ka kandidat konsensual për kryetar të

LDK-së. Ai ka thënë se në Kuvendin e Nëntë Zgjedhor secili që do mund ta propozojë kandidaturën për kryetar të LDK-së. Një burim brenda LDK-së i ka thënë gazetës "Epoka e re" se në të dyja mbledhjet e kryesisë së LDK-së Isa Mustafa ka marrë përkrahjen si



kandidat konsensual për të qenë sërish kryetar i partisë

FAQE 3

Syla: Elementet kyçe të fazës së parë të transformimit të FSK-së në ushtri nuk janë realizuar

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vasa, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Dedaj: Ekstradimi i Morinës mund t'i prishë marrëdhëniet ndërshtetërore

SHKUP, 2 GUSHT - Serbia edhe zyrtarisht ka dërguar kërkesë për ekstradimin e ish-ushtarit të UÇK-së, Tomor Morina, i cili u arrestua ditë më parë në pikën kufitare Bllacë. Nga Ministria e Drejtësisë thonë se kërkesa e Serbisë të hënën do t'i dorëzohet gjykatës e cila merret me rastin. Për ekstradimin e Morinës ka folur edhe ambasadori i Kosovës në Maqedoninë e Veriut, Gjergj Dedaj.

Ai tha se ekstradimi nuk duhet të vijë në shprehje pasi, siç tha, mund të ndodhë prishja e marrëdhënieve ndërshtetërore në mes të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. "Megjithatë, kujtoj se ekstradimi i tij komplet kundër të drejtave njerëzore është antiligjor, i papranueshëm dhe nuk do të duhej të ndodhte, sepse një ekstradim eventual nuk është më në dëm të fatit personal të Tomor

Morinës. Por mund të ketë pasojë edhe për marrëdhëniet ndërshtetërore në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nuk do të donim që raste të tilla të ndikojnë për prishjen eventuale, për çka nuk jemi të interesuar fare si Kosovë", tha Dedaj. Ai tha se sapo ka marrë lajmin për arrestimin e Morinës, ka ndërprerë pushimin dhe ka ardhur në Shkup.



Palmeri: Krijimi i qeverisë, sfida e tanishme për Kosovën

"Ne duam që Kosova t'i fillojë përpjekjet për formimin e një qeverie sa më shpejt që të jetë e mundur dhe do të dëshironim që ajo qeveri pastaj t'i kthehet sa më shpejt dialogut, përfshirë pezullimit të tarifës ndaj mallrave të Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës", tha zëvendësndihmësekretari amerikan i Shtetit, Matthew Palmer



PRISHTINE, 2 GUSHT - Zëvendësndihmësekretari amerikan i Shtetit për çështjet e Evropës dhe Euroazisë, Matthew Palmer, tha se sfida e tanishme e Kosovës është krijimi i një qeverie e cila do ta kthente vendin në dialogun me Serbinë dhe do ta pezullonte tarifën ndaj mallrave serbe. Në një intervistë për "Zërin e Amerikës", Palmer theksoi se përcaktimi i parametrave të negociatave është përgjegjësi e palëve dhe se përqendrimi vetëm te hartat dhe territoret zhvendos vëmendjen nga rëndësia e arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse për normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë.

Duke iu përgjigjur pyetjes se a besoni se pas dorëheqjes së kryeministrit të Kosovës Ramush Haradinaj, ekziston një rrugë e qartë për Kosovën dhe Serbinë që ta rifillojnë dialogun mes tyre, Palmer tha se "ne kemi shumë

shpresë që Beogradi dhe Prishtina mund të gjejnë një rrugë për t'u kthyer në tryezën e bisedimeve dhe pastaj ta gjejnë rrugën për arritjen e një marrëveshjeje që të ketë mbështetje reciproke, që të rezultonte në normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes tyre. Dhe kjo do ta hapte rrugën për një të ardhme evropiane për të dyja vendet, për Kosovën dhe për Serbinë". "Mendoj se ajo që është e nevojshme tani është krijimi i një qeverie në Kosovë. Kjo është sfida e menjëhershme. Ne duam që Kosova t'i fillojë përpjekjet për formimin e një qeverie sa më shpejt që të jetë e mundur. Ne do të dëshironim që ajo qeveri pastaj t'i kthehet sa më shpejt dialogut, përfshirë pezullimit të tarifës ndaj mallrave të Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës. Ne shpresojmë që kjo të fillojë së shpejti.", tha Palmer.

Ai ka thënë se ne tani jemi të

përqendruar te rikthimi i palëve në tryezën e bisedimeve.

"Me t'u kthyer në tryezë, sigurisht është pastaj çështja se për çfarë do të negociojnë. Dhe u takon në të vërtetë vetë palëve të përcaktojnë se cilat janë parametrat e asaj që do të negociohet. Asnjëra nga palët nuk do të detyrohet të bëjë diçka që nuk mund ta bëjë. Por ne do të dëshironim që negociatorët të negocionin me vullnet të mirë për një marrëveshje që mund të çojë në njohje reciproke mes Kosovës dhe Serbisë dhe në një rrugë drejt Evropës. Shtetet e Bashkuara nuk do të vendosin

ose diktojnë se cila do të jetë sfera e negociatave.

Në lidhje me atë që është përfolur shumë se presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka arritur një marrëveshje të fshehtë me homologun e tij nga Serbia, Aleksander Vuçiq, që përfshin shkëmbimin e territoreve, Palmeri thotë se nuk ka parë diçka të tillë. "Sigurisht që palët kanë biseduar për një kohë të gjatë se cilat janë parametrat e një marrëveshjeje. Nuk e di se cilat janë çështjet thelbësore sa i përket territorit ose ndonjë komponenti të veçantë të kësaj.

Çdo marrëveshje që do të arrihet do të jetë gjithëpërfshirëse, do të ketë komponente politike, të sigurisë, ekonomike, tregtare, kulturore, për shembull kur është fjala për pronën e Kishës Ortodokse në Kosovë. Pra, unë mendoj se përqendrimi vetëm te harta dhe territoret e zhvendos vëmendjen nga domethënia e vërtetë e marrëveshjes gjithëpërfshirëse për normalizimin. Përkufizimi i normalizimit është përgjegjësi e palëve. Dhe ato mund ta bëjnë këtë vetëm në tryezën e dialogut", ka thënë Palmer.

Basha: Plani i Ramës është vjedhja, ja përse Shqipëria është në krizë

TIRANË, 2 GUSHT - Në takimin me strukturat e PD-së në Peqin, kreu i opozitës, Lulzim Basha, bëri përgjegjës Edi Ramën për krizën e thellë ekonomike të vendit. "Nga mëngjesi deri në darkë plani i Edi Ramës është grabitja, vjedhja. Kjo është arsyeja pse Shqipëria është e papunë. Kjo është arsyeja se pse Shqipëria lëngon në krizën më të thellë ekonomike. Kjo është arsyeja pse shëndetësia, arsimit dhe gjithçka tjetër janë në kolaps. Kjo është arsyeja pse po përjetojmë emigracionin më gërryes dhe

më të rrezikshëm se ai i fillim viteve '90", theksoi kryetari Basha. Lideri i opozitës vuri në dukje se përqendrimi i ekonomisë dhe pasurive të vendit në duart e pak njerëzve përreth Edi Ramës ka thelluar varfërinë në vend. "Shqiptarët po varfërohen, sepse po grabiten. Shqipëria po plaçkëtet dhe po shkatërrohet nga Edi Rama me një grusht biznesmenësh grabitqarë, që ndajnë paratë dhe pasuritë me njëri-tjetrin. Këta janë një grusht njerëzish të pamëshirshëm, biznesmenë

parazitare dhe grabitqarë, që nuk prodhojnë, nuk krijojnë, por vetëm vjedhin dhe grabisin djersën, pronat e shqiptarëve, në bashkëpunim me Edi Ramën.

Shqiptarët janë pa punë, sepse ekonominë dhe mundësitë ekonomike i kanë marrë oligarkët dhe klientët e Edi Ramës, shpresat e tyre i ka vurrë Edi Rama me oligarkët grabitqarë. Ata nuk lejojnë asnjëri tjetër të krijojë, të konkurrojë, të ndërtojë, të provojë", tha Basha.



Sot (e shtunë) Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) mban Kuvendin e Nëntë Zgjedhor

LDK-ja, pa kandidat konsensual për kryetar

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) as të premten nuk ka arritur ndonjë marrëveshje për një kandidat konsensual për kryetar të partisë. Nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, pas mbledhjes së kryesisë ka bërë me dije se nuk ka kandidat konsensual për kryetar të LDK-së. Ai ka thënë se në Kuvendin e Nëntë Zgjedhor secili që do mund ta propozojë kandidaturën për kryetar të LDK-së. Një burim brenda LDK-së i ka thënë gazetës "Epoka e re" se në të dyja mbledhjet e kryesisë së LDK-së Isa Mustafa ka marrë përkrahjen si kandidat konsensual për të qenë sërish kryetar i partisë



Mustafa, por ai nuk ka dhënë asnjë qëndrim", ka thënë ky burim.

Një ndër themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Milazim Krasniqi, ka ftuar lider-shipin e kësaj partie që në Kuvendin e Nëntë Zgjedhor, i cili do të mbahet këtë të shtunë, të lejojë një garë fer për të gjithë ata që shprehin interesim për ta udhëhequr partinë. Ai ka

deklaruar për "Epokën e re" se statuti aktual i partisë e favorizon liderin e partisë për të qenë sërish kryetar. "Absurdi është që në statutin e partisë e kanë futur normën që praktikisht mund të ketë vetëm një kandidat. Nëse kuvendi i ka mbi 350 delegatë dhe nëse për të kandiduar për kryetar të LDK-së kërkohen nënshkrimet e mbi 50 për qind të delegatëve, i bie që nuk ka

mundësi të jenë dy kandidatë. Pra, qëllimisht është futur kjo normë në statut, në mënyrë që të pengohet gara demokratike. Prandaj, në këtë aspekt është zor të parashikohet, sepse kufizimet në statut janë të atilla që favorizojnë një kandidat. Kur kemi favorizime të një kandidati, zakonisht favorizohet ai që është kryetar i partisë", ka thënë Krasniqi.

Sejdiu: Delegatëve mos t'u imponohet asnjë kandidaturë për kryetar

Fatmir Sejdiu, i cili ka shprehur gatishmërinë e tij që të jetë në krye të LDK-së, ka thënë për "KosovaPress" të premten se nuk është pjesë e konsensusit të përfolur. Sipas Sejdiut, delegatët e Kuvendit të LDK-së në mënyrë të lirë dhe demokratike duhet ta zgjedhin kryetarin e partisë dhe

në asnjë mënyrë këtij organi mos t'i imponohet asnjë kandidaturë. "I pashë raportimet në media. Jo, unë nuk jam pjesë e këtij konsensusi të përfolur. Qëndrimet e mia lidhur me kandidaturën time i kam shprehur edhe publikisht dhe për këtë e kam njoftuar edhe kryetarin aktual të LDK-së, z. Mustafa, në

takimin e djeshëm dhe kryesinë qendrore nëpërmes tij. Është e ditur që delegatët e Kuvendit si organi më i lartë i LDK-së duhet ta zgjedhin kryetarin e LDK-së në mënyrë të lirë dhe demokratike dhe këtij organi nuk do të duhej t'i shërbehet e as të imponohet asnjë kandidaturë", thotë Sejdiu.

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 2 GUSHT - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) edhe të premten ka mbajtur mbledhjen e kryesisë, në të cilën ka diskutuar për përgatitjet e Kuvendit të Nëntë Zgjedhor të saj i cili do të mbahet sot (e shtunë) dhe për arritjen e një konsensusi për zgjedhjen e liderit të ri. Nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, pas mbledhjes së kryesisë ka bërë me dije se nuk ka kandidat konsensual për kryetar të partisë. Ai ka thënë se të shtunën kushdo që do për të qenë kandidat për kryetar mund t'i hyjë kësaj gare. "Nuk ka kandidat konsensual dhe nesër secili që do mund ta propozojë veten për kryetar të LDK-së", ka thënë ai.

Kur Haziri është pyetur pse disa njerëz në LDK janë kundër rizgjedhjes së Isa Mustafës, ai këto i quajti më shumë spekulime sesa të vërteta. "Isa Mustafa po i prin mirë partisë në këto ditë kur LDK po i jep epilogun një ngjarje të madhe siç është Kuvendi Zgjedhor. Ne me kryetarët e degëve të LDK-së jemi duke punuar për mobilizimin e delegatëve të partisë. 355 delegatë

tashmë veçse kanë konfirmuar pjesëmarrjen. LDK-ja po përaftron qëndrimin e kandidatit që përfaqëson unitetin e të gjitha strukturave. Natyrisht se në të njëjtën kohë garanton pjesëmarrje për të gjithë ata që nesër i paraqesin kandidaturat. Gjithashtu, gjatë mbledhjeve është përafuar mbështetja lidhur me kandidatin që paraqet unitetin. Unë i përmbahen angazhimit tim, ne po i finalizojmë punimet", ka thënë Haziri.

Deri më tani figurat më të përfolura për kandidat të mundshëm për kryetar të ardhshëm të LDK-së janë Isa Mustafa, Agim Veliu, Fatmir Sejdiu dhe Lutfi Haziri. Fatmir Sejdiu dhe Lutfi Haziri kanë konfirmuar se do t'i hyjnë garës për kryetar të partisë, kurse Isa Mustafa dhe Agim Veliu nuk kanë dhënë ende një qëndrim nëse do të jenë kandidatë për kryetar të LDK-së. Megjithatë, një burim brenda LDK-së i ka thënë gazetës "Epoka e re" se në të dyja mbledhjet e kryesisë së LDK-së Isa Mustafa ka marrë përkrahje si kandidat konsensual për të qenë sërish kryetar i partisë. "Si kandidat konsensual për kryetar të LDK-së në të dyja mbledhjet është përmendur emri i z.

Kthimi i qytetarëve nga Siria e bëri Kosovën referencë globale kundër terrorizmit

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se Kosova është marrë si referencë nga ShBA-ja kur flitet për masat në luftën kundër terrorizmit global. "Ndër vendimet më të vështira dhe puna më e ndjeshme që kam bërë gjatë këtij mandati si ministër i Drejtësisë ka qenë vendimi për kthimin e qytetarëve tanë që gjendeshin në zonat e luftës në Siri. Kam qenë i vendosur që

emri i Republikës së Kosovës të mos jetë referencë e asnjë aktiviteti që lidhet me terrorizmin dhe, po ashtu, shumë i vendosur që fëmijët dhe viktimat e manipulimit të mos mbeten në zona të konfliktit. Sot të dyshuarit janë para drejtësisë dhe ballafaqohen me të, ndërsa fëmijët në rehabilitim kanë filluar një jetë re", ka thënë Tahiri.

Ministri Tahiri ka theksuar se Republika e Kosovës ka treguar

përkushtimin e plotë ndaj rendit dhe ligjit, por po ashtu përkushtimin ndaj shtetasve të saj. "Jam krenar që falë këtij përkushtimi sot Republika jonë është referencë globale kundër terrorizmit dhe referencë globale për rigjenerimin social të viktimave të kësaj dukurie. Ky përkushtim tashmë ka marrë kredencialet e veta edhe nga Uashingtoni dhe zyrtarët më të lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës", ka deklaruar Tahiri.



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, më 5 gusht ka thirrur mbledhje të kryesisë në të cilën do të diskutohet për thirrjen

Kuvendi në prag



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe shefi i koalicionit PAN, Kadri Veseli, të premten zyrtarisht kanë qartësuar situatën në të cilën ndodhet vendi pas dorëheqjes së Ramush Haradinajt nga posti i kryeministrit. Thaçi, ashtu siç e parasheh Kushtetuta, ka kërkuar nga koalicioni fitues që ta propozojë mandatarin e ri për kryeministër, ndërkohë Veseli e ka njoftuar presidentin se PAN-i nuk ka mandatar tjetër. Kryeparlamentari Kadri Veseli ka bërë me dije se për të hënë ka thirrur mbledhjen e kryesisë së Kuvendit për të diskutuar rreth shpërndarjes së këtij institucioni. Sipas tij, tani zgjedhjet e parakohshme janë e vetmja alternativë

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 3 GUSHT - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të premten përmes një shkrese zyrtare ka kërkuar nga Kadri Veseli, si i pari i koalicionit PAN, ta propozojë kandidatin e

ri për ta mandatar për formimin e Qeverisë së Kosovës. Ky i fundit e ka njoftuar shefin e shtetit se PAN-i nuk ka mandatar tjetër për kryeministër dhe se zgjedhjet tani janë e vetmja zgjidhje.

Në përgjigjen e tij zyrtare, kryeparlamentari Veseli e ka

njoftuar presidentin se për të hënë ka thirrur mbledhjen e kryesisë së Kuvendit për ta shpërndarë Kuvendin.. "Si kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës kam vendosur që të hënë, më 5 gusht 2019, të thërras një mbledhje të kryesisë së

Kuvendit të Kosovës, bashkë me kryetarët e grupeve parlamentare, në funksion të veprimeve të cilat duhet t'i ndërmarrim në ditët në vazhdim, konkretisht për të diskutuar për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme për shpërndarjen e legjislaturës aktuale të Kuvendit të Kosovës", ka shkruar Veseli në profilin e vet në "Facebook". Ai ka treguar se kjo mbledhje ka për qëllim t'i saktësojë në mënyrë zyrtare dhe institucionale qëndrimet e çdo grupi parlamentar në lidhje me situatën e krijuar pas rënies së Qeverisë së Kosovës si dhe konkretizimin e hapave për përcaktimin sa më të shpejtë të datës së zgjedhjeve të parakohshme. "Ndërkohë, si

udhëheqës i koalicionit PAN i kam kthyer përgjigje presidentit të Republikës së Kosovës dhe e kam njoftuar se nuk do të ketë mandatar tjetër. Kam thënë dhe e përsëris: zgjedhjet janë të pashmangshme dhe janë në interes të Republikës së Kosovës. Partia Demokratike e Kosovës, si gjithmonë, edhe tash, edhe në të ardhmen, i beson fuqishëm legjitimitetit qytetar", është shprehur ai, duke shtuar se Kosova ka nevojë për një qeveri të re. "Qytetarët e Kosovës meritojnë një qeverisje të re, që punon për zhvillim të hovshëm ekonomik, që e lufton korrupsionin pa kompromis, që u ofron perspektivë të rinjve tanë këtu, në Kosovë, që garanton mundësi të barabarta për të

1 e seancës së jashtëzakonshme për shpërndarjen e legjislaturës së VI

të shpërndarjes



Kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka thënë të premtën se ende nuk ka marrë ftesë nga presidenti Hashim Thaçi për të biseduar për gjendjen aktuale dhe një proces të ri zgjedhor.

Haradinaj është shprehur se është i interesuar ta shpërndajë Kuvendin dhe se do t'i bashkohet mocionit për një gjë të tillë dhe të shkohet në zgjedhje të jashtëzakonshme.

Kërkesa e presidentit Thaçi drejtuar PAN-it për një mandatar të ri për kryeministër ka nxitur reagimin e subjekteve politike, derisa njohësit e rrethanave politike këtë veprim të presidentit e kanë parë si veprim të nevojshëm kushtetues. "Presidenti ka ndër marrë një veprim kushtetues, por më shumë vonesë. Kanë kaluar dy javë që nga dorëheqja e kryeministrit dhe presidenti ka mundur ta bëjë këtë menjëherë. Por duket se ka kalkuluar edhe me zgjedhjet në LDK, në mënyrë që të shohë se kush do të zgjedhet kryetar dhe a ka vërtet gjasa që të gjendet një mandatar i ri që do ta çonte mandatin qeverisës deri në fund. Të gjithë partitë

politike janë deklaruar publikisht për zgjedhje, por dorëheqja e Ramush Haradinajt i ka gjetur në befasi dhe nuk është se ato janë gati për zgjedhje siç deklarohen. Këtë situatë po e shfrytëzon presidenti, mbase për ndonjë kalkulim tjetër politik", ka thënë analisti politik Imer Mushkolaj për gazetën "Epoka e re".

Pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj të gjitha partitë politike kanë shprehur gatishmërinë e tyre për zgjedhje, duke e ftuar presidentin e vendit që ta caktojë sa më shpejt datën e zgjedhjeve.

Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, ka thënë se kërkesa e presidentit ndaj partnerëve të PAN-it për nominimin e një kryeministri të ri është shfrytëzim i së drejtës së tij kushtetuese. "LDK-ja në këtë fazë sillet me kulturë institucionale, por duke qenë në vigjilje të kuvendit, qëndrimi ynë është që vendi kërkon zgjedhje", ka deklaruar Haziri pas mbledhjes së kryesisë së LDK-së.

Lajmin për shpërndarjen e Kuvendit e ka mirëpritur edhe PSD-ja. "Lajm shumë i mirë që

Kuvendi po shpërbëhet e vendi po shkon në zgjedhje. Paqartësive, shpifjeve dhe propagandave po u vjen fundi. Kosovës i duhet ndryshimi dhe i duhet sa më shpejt. PSD do të jetë subjekt i fuqishëm që do ta ndikojë këtë ndryshim. Barazia, mirëqenia dhe zhvillimi ekonomik do t'ia zënë vendin keqeverisjes dhe populizmit. Gati për zgjedhje dhe të përgatitur për rritje e përgjegjësi", ka shkruar në profilin e vet në "Facebook" deputeti i PSD-së, Dardan Molliqaj.

Që nga dorëheqja e Haradinajt, partitë politike i kanë nisur aktivitetet e tyre përgatitore për zgjedhje të parakohshme.

Dorëheqja e Ramush Haradinajt nga pozita e kryeministrit të Kosovës ka krijuar shumë paqartësi jo vetëm politike, por edhe juridike dhe kushtetuese, pasi ka ngritur dilemat nëse ka apo jo aktualisht Kosova qeveri, qoftë edhe me kompetenca të kufizuara. Haradinaj ka dhënë dorëheqje nga pozita e kryeministrit më 19 korrik, pasi është ftuar nga Prokuroria Speciale me seli në Hagë për t'u intervistuar në cilësinë e të dyshuarit.

Një person në gjendje të rëndë nga ethet e minjve, mjekët apelojnë për kujdes

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK), përmes një komunikate ka bërë thirrje për kujdes të shtuar nga ana e qytetarëve për shkak të rrezikut të përhapjes së sëmundjes - ethet e minjve. "Këtë vit, një rast i raportuar nga Klinika Infektive, është në gjendje të rëndë klinike", thuhet në komunikatë.

Burimi i infeksionit të sëmundjes janë minjtë. Në organizmin e njeriut virusi hyn përmes tri mënyrave: traktit respirator, traktit tretës dhe përmes lëkurës, bëjnë të ditur zyrtarët shëndetësorë. "Pakujdesia gjatë ruajtjes së ushqimit dhe konsumimi i frutave të malit të palara mund ta shkaktojë sëmundjen vdek-

jeprurëse", thuhet më tutje në komunikatë.

Trajtimi i sëmundjes bëhet me sukses në rast të paraqitjes në kohë të mjekut. "Në qoftë se të sëmurët kërkojnë ndihmë me vonesë, paraqiten komplikime, e që mund ta shkaktojnë bllokimin e veshkave", thuhet në komunikatën e IKShPK-së.



gjithë dhe që sjell më shumë të reja e të rinj, ndërmarrës e intelektualë, në lidhshimin institucional, për ndryshimet e mëdha që janë të domosdoshme", ka deklaruar Veseli. Më tej, ai ka sqaruar se Kuvendi i Kosovës është i obliguar edhe nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Rregullorja e Punës së Kuvendit që t'i ndër marrë veprimet e nevojshme ligjore për tejkalimin legal dhe institucional të situatës aktuale. "Shteti nuk guxon të mbetet në vakum institucional dhe pa vendimmarrje legjitime. Është në interesin e qytetarëve dhe të shtetit që të lëvizim shpejt në drejtim të legjitimitetit të ri të institucioneve. Dhe kjo mund të arrihet vetëm përmes zgjedhjeve demokratike", ka

thënë Veseli, duke shtuar se si kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës do t'i ndër marrë të gjitha veprimet e nevojshme që vendi sa më shpejt të zhvillojë zgjedhje të lira dhe demokratike. Ai ka bërë me dije se Republika e Kosovës ndodhet para sfidave të mëdha, përballja me të cilat del e suksesshme vetëm duke pasur institucione legjitime dhe qeveri të zgjedhur nga vota e lirë qytetare. "Ju siguroj se vendi ynë ka të gjitha kapacitetet e nevojshme institucionale dhe përvojën e dëshmuar për të organizuar një proces zgjedhor në përputhje të plotë me standartet më të larta demokratike. Është koha për ta dëgjuar vullnetin e sovranit", ka vlerësuar Veseli.

Haradinaj bën homazhe te lapidari i komandant 'Rokit'

KAMENICË, 2 GUSHT (ER) - Kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, me rastin e 18-vjetorit të vdekjes së Rahim Beqirit - komandant 'Roki', të premtën ka bërë homazhe te lapidari i tij në fshatin Kopërnice të Komunës së Kamenicës. Kryeministri Haradinaj ka thënë se si çdo popull që i ka qëllimet dhe interesat e veta, e të cilave duhet t'i shërbejmë, edhe shqiptarët i kanë, por interesat e shqiptarëve nuk janë interesa armike për popujt e tjerë, por janë të

drejta për ne si popull. Para të pranishmëve Haradinaj ka thënë se duke i përfunduar punët tona, ashtu siç i kanë përfunduar heronjtë tanë, të cilët kanë dhënë gjithçka nga vetja deri në flajm, sikur komandant "Roki", është detyrë e jona të jemi në kohë, të kërkojmë llogari dhe të besojmë në vetvete. "Nëse vazhdojmë në këtë rrugë, ju siguroj se do t'i sigurojmë të drejtat tona si komb shqiptar, do t'i garantojmë ata që jetojnë me ne dhe do të jemi miq për miqtë. Një

popull që është i dobët në ekonomi, në siguri, në arsim, nuk mund të jetë mik i askujt, por vetëm barrë e të tjerëve", ka thënë Haradinaj, duke thënë se është i nderuar që tradicionalisht bashkohet në vendin ku nderohet vepra e komandant Rokit. Nga një fjalë para të pranishmëve e mbajtën edhe kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, bashkëluftëtari nga Tetova Fexhri Hasipi dhe djali i komandant Rokit, Vedat Beqiri.



Ministri i Mbrojtjes i dhuron 'Medalje për shërbim të shquar' nënkolonelit Henrik Krogh



PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha, ka pritur të premtën në takim lamtumirës nënkolonel Henrik Krogh, ushtrues detyre i shefit të këshilltarëve të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT). Ministri Berisha e falënderoi nënkolonelin Krogh për angazhimin gjatë gjithë viteve të shërbimit të tij në Kosovë, në veçanti për kontributin e tij rreth tranzicionit të Forcës së

Sigurisë të Kosovës. Ministri i Mbrojtjes për merita të veçanta gjatë shërbimit të tij, nënkolonelit Krogh i dhuroi "Medaljen për shërbim të shquar". Oficeri danez Krogh gjatë takimit evokoi kujtime mbresëlënëse nga misioni i tij në Kosovë, në veçanti shprehu falënderim për mikpritjen e institucioneve dhe të popullit të Kosovës, duke nënvizuar se Kosova gjithmonë do të mbetet në zemrën e tij.

Nënkoloneli Krogh gjatë viteve të shërbimit në kuadër të NALT-it ka dhënë kontribut të çmuar në procesin e tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ai, po ashtu, ka qenë i angazhuar në Kosovë qysh në vitin 1999 si anëtar i grupit të forcave daneze në kuadër të KFOR-it, ndërsa në vitin 2004 ka qenë komandant i kontingjentit danez dhe në vitin 2008 ka shërbyer si zyrtar ndërlidhës i KFOR-it në Qeverinë e Kosovës.

Koordinatori i Qendrës Kulturore të Kosovës në Bursa viziton kompaninë e Ujësjetllësit 'Prishtina'

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Koordinatori nga Qendra Kulturore e Kosovës në Bursa të Turqisë, Recep Gunduz, e ka vizituar kompaninë rajonale të ujësjetllësit "Prishtina" sh. a. Gunduz u prit në këtë takim nga kryeshefi ekzekutiv i kompanisë rajonale të ujësjetllësit "Prishtina", Ilir Abdullahu dhe zëvendëskryeshefi Kujtim Xhelili. Gunduz u njoftua nga afër me fabrikën më të re të ujit të pijshëm në Republikën e Kosovës, fabrika në Shkabaj, për gjendjen e përgjithshme të infrastrukturës aktuale të rrjetit të ujësjetllësit, të ujërave të zeza, për furnizimin e qëndrueshëm me ujë të pijshëm për komunat në të cilat KRU "Prishtina" ofron shërbime të ujësjetllësit dhe kanalizimit, për



projektet specifike zhvillimore, për sfidat dhe vështirësitë me të cilat po përballen ujësjetllësi rajonal

"Prishtina". Ndër të tjera, kryeshefi Abdullahu ka diskutuar edhe për teknologjinë

e re të përpunimit të ujit në Shkabaj dhe ka folur për mundësitë për bashkëpunim me

ujësjetllësin e qytetit të Bursës së Republikës së Turqisë, duke treguar edhe për misionin konkret për realizimin e projekteve gjithëpërfshirëse të ujërave, gjithnjë në shërbim të konsumatorëve të vendit.

Koordinatori nga Qendra Kulturore e Kosovës në Bursa të Turqisë, Recep Gunduz, ka ofruar bashkëpunim për shkëmbim informacionesh dhe përvojash në mes të të dy ujësjetllësve në të ardhmen e afërt. KRU "Prishtina" ofron shërbime për ujësjetllës dhe kanalizim në 40 për qind të territorit të Republikës së Kosovës, në gjithsej tetë komuna: Prishtinë, Fushë-Kosovë, Obiliq, Shtime, Gracanicë, Lipjan, Podujevë dhe Drenas.

Nënkryetari Lushtaku inspekton punimet e asfaltimit të rrugëve në Kopiliq

SKENDERAJ, 2 GUSHT (ER) - Nënkryetari i Komunës së Skenderajt, Nuredin Lushtaku, ka dalë në terren së bashku me inxhinierët e kësaj komune për t'i inspektuar punimet e projektit të asfaltimit të mbi tri kilometrave rrugë, përkatësisht

segmente dhe degëzime në lagjen "Havolli" dhe rruga "Pavarësia" në Kopiliq. Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", rreth ecurisë së këtij projekti ka shkruar kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari. Ai ka thënë se ky projekt që është

nisur vetëm pak ditë më parë, sipas të gjitha parashikimeve, pritet të përfundojë shumë shpejt. "Banorët tanimë nuk do ta vuajnë mungesën e infrastrukturës rrugore me standarde të pranuar", ka shkruar Jashari.



Syla: Elementet kyçe të fazës së parë të transformimit të FSK-së në ushtri nuk janë realizuar

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Shemsi Syla, ka thënë të premtën se gjendja në Ministrinë e Mbrojtjes është alarmante për faktin se elementet kyçe të fazës së parë të planit gjithëpërfshirës të transformimit të FSK-së në ushtri nuk janë realizuar

EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 GUSHT - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Shemsi Syla, i shoqëruar edhe nga zyrtari tjetër i kësaj lëvizje, Enver Dugolli, në një konferencë për media të premtën kanë paraqitur qëndrimin e kësaj partie për kundërshtimin e zvarritjes nga ana e presidentit për datën e zgjedhjeve dhe takimit për këtë datë.

Syla ka folur edhe për ngecjet për funksionalizimin e Forcës së Sigurisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, përkundër ngritjes së kapaciteteve ushtarake të shteteve në rajon, përkatesisht Serbisë që ende ka një qasje armiqësore ndaj Kosovës. "Gjendja në Ministrinë e Mbrojtjes është alarmante. Elementet kyçe të fazës së parë të planit gjithëpërfshirës të transformimit të FSK-së në ushtri nuk janë realizuar", ka thënë Syla.

Ai ka përsëritur objektivat që është dashur të arrihen më 21 maj 2019 të fazës A+120 ditë, si: 1. Riorganizimi i Ministrisë së FSK-së në Ministri të Mbrojtjes dhe Komandës së Forcave Tokësore në Shtabin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (objektivë e përcaktuar). 2. Vendosja e elementit drejtues (udhëheqës) (objektivë e përcaktuar). "Projektet kryesore gjatë kësaj faze të cilat tashmë është dashur të jenë të përfunduara, si: 1. krijimi i dokumenteve strategjike; dhe 2. vendosja e bazës doktrinare. Fatkeqësisht, asnjë nuk është e gatshme apo e



miratuar nga autoritetet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së dhe për pasojë një pjesë e madhe e personelit ushtarak dhe civil të kësaj ministrie dhe FSK-së gjendet në një situatë të vazhdueshme kaosi", ka thënë Syla. Sipas tij, krahas këtij kaosi Ministria e Mbrojtjes për gjashtë muaj ka përdorur vetëm tre për qind të shpenzimeve kapitale. "Buxheti i ndarë për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës e sidomos shumica për shpenzime kapitale të tregun të vërtetën se sa ishte e përkushtuar qeveria e rrëzuar, për ngritjen e kapaciteteve mbrojtëse", ka thënë ai.

Deputeti Syla ka thënë se marrë parasysh situatën e sigurisë dhe kapacitetin ushtarak të vendeve të rajonit, buxheti për Forcën ka qenë jo serioz dhe se Vetëvendosja me kohë e ka ngritur këtë çështje.

Ai më tej ka folur edhe për keqpërdorimet që, sipas tij, po përgatiten në Ministrinë e Mbrojtjes. Syla iu bëri thirrje zyrtarëve civilë që mos të marrin për bazë asnjë vendim të nënshkruar pas datës së dorëheqjes së ish-kryeministrit dhe rrëzimit të qeverisë. "Përderisa qeveria e rrëzuar ka shfaqur paaftësi për formimin e ushtrisë dhe keqmenaxhim të parasë publike, ne i bëjmë thirrje që mos të ndërmarrin ndonjë veprim tani, në këtë kohë, për ta mbuluar paaftësinë dhe keqmenaxhimin", ka thënë ai.

Enver Dugolli u përqendrua te çështja e kapaciteteve ushtarake në rajon dhe pozicioni i Kosovës. "Ditët e fundit jemi dëshmitarë të një ekspansioni të fuqishëm të Serbisë në fushën e armatimit me armë dhe pajisje tejet moderne. Kontingjenti i mjeteve të blinduara, bashkë me avionët dhe

helikopterët, janë një sinjal i qartë se Serbia po lëviz fuqishëm si forcë dominuese ushtarake në rajon", ka thënë Dugolli, duke shtruar pyetjen se për çfarë po armatohet Serbia. Sipas tij, të gjitha opsionet apo variantet mund të jenë të sakta përveç atij që deklaroi presidenti Vuçiq kur thotë se po armatohet për ta mbrojtur vendin. "Në fakt, ka diçka këtu, edhe mund të jetë e rrezikuar sikur në të kaluarën kur Millosheviqi kryente gjenocid në Kosovë. Ky mund të jetë rreziku ngaqë edhe planet ndaj Kosovës nuk është se dallojnë shumë nga ajo kohë. Një gjë dihet, derisa Serbia shfaq haptazi aspirata armiqësore ndaj nesh, Kosova është caku i parë i rrezikut", ka thënë ai.

Dugolli ka shtuar se mekanizmat e kontrollit ndërkombëtar si duket për Serbinë nuk vlejnjë edhe aq

pasi që në gjithë këtë situatë nuk ka reagime. "Kemi një heshtje të çuditshme. Për këtë rastin e fundit u paraqit edhe një kontradiktë, një vend si Rumania e ndali konvoin me tanke dhe autobllinda nga Rusia për Serbinë. Ndërsa pak më vonë të njëjtat u transportuan përmes vijës ajrore të Hungarisë. Le të kujtojmë se Hungaro Control e mbikëqyr edhe hapësirën e lartë ajrore të Kosovës në emër të NATO-s", ka thënë Dugolli. Ai ka theksuar se për ta ndërruar këtë gjendje, ashtu siç duhet, duhet të shkohet urgjentisht në zgjedhje të lira dhe demokratike. "Me ç'rast do të krijohej një legjitimitet i ri politik dhe institucional. Qeveria dhe institucionet e ardhshme duhet ta kthejnë fokusin e vërtetë në investime dhe reforma të mëdha në këtë fushë tejet të rëndësishme", ka thënë Dugolli.

Në QKUK fillojnë punën 100 infermierë/e të profileve të ndryshme

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Njëqind infermierë/e të profileve të ndryshme e kanë filluar sot punën në kuadër të klinikave të Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës (QKUK). Me këtë rast, drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-së, dr. Basri Sejdiu, u ka uruar mirëseardhje dhe punë të mbarë. "Është kënaqësi e madhe që po punësoheni në

QKUK dhe nuk keni pasur nevojë të shkoni jashtë vendit. Ju jeni shumë të rëndësishëm për pacientët", u shpreh drejtori Sejdiu. Ai kërkoj angazhim maksimal nga ta, me qëllim që pacientëve t'u ofrohen shërbime sa më kualitative. Sipas tij, në QKUK do të ketë edhe konkurse të tjera për punësim të infermierëve të profileve të ndryshme.

Prej 100 infermierëve që filluan punën, 35 infermierë/e janë me shkollim të mesëm në infermieri, 35 me shkollim të mesëm, pesë mami, infermiere akusherike me shkollim të mesëm, pesë me shkollim bachelor, pesë infermier/e pediatrike, pesë laborantë drejtimi mjekësor, shtatë fizioterapeutë bachelor dhe tre me shkollim të mesëm.



LV-ja dorëzon kallëzim penal për ish-ministrat e Bujqësisë

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Deputeti dhe anëtari i Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Sali Zyba, ka dorëzuar të premten kallëzim penal për ish-ministrat e Bujqësisë, Nenad Rikallo, Memli Krasniqi, Blerand Stavileci, për sekretarin e Ministrisë së Bujqësisë, Kapllan Halimi, drejtorin e Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë, Ekrem Gjokaj dhe ish-drejtorin e kësaj agjencie, Elhami Hajdari. "Jemi të vetëdijshëm që tashmë dhjetëra fermerë për vite të tëra kanë kallëzuar në prokurori, në polici për keqpërdorimet e mëdha, qoftë me grantet e qoftë me subvencionet. Qindra ankesa e padrejtësi kemi pranuar prej tyre në këtë drejtim. Ftoj edhe

Auditorin e Përgjithshëm ta dorëzojë në Prokurori raportin e performancës lidhur me procesin e menaxhimit të granteve dhe subvencioneve në sektorin e bujqësisë publikuar në maj 2019. Neni 24 i Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës e obligon këtë institucion të veprojë kur gjen shkelje dhe keqpërdorime të parashë publike", ka thënë deputeti Zyba.

Ai ka kërkuar nga Prokuroria që të mos vonohet me këto hetime. "Tashmë ka fakte të bollshme prej fermerëve, prej këtij kallëzimi, e veçanërisht prej raportit të performancës së Auditorit, lidhur me procesin e menaxhimit të granteve dhe subvencioneve



në sektorin e bujqësisë. Kallëzimi i sotëm i mbulon dy çështje: grantet në shumën 4 milionë euro të dhëna për katër konsurcione dhe një kompani

secila prej tyre e lidhur drejtpërdrejt me drejtues politikë dhe ish-ministra si dhe keqpërdorimet prej vitit 2014 në këtë fushë", ka deklaruar ai.

Zyba ka shtuar se prej shumë muajsh kanë ballafaquar zyrtarët e ministrisë për këtë temë e të ngjashme, veçanërisht në Komisionin Parlamentar për Bujqësi, Pylltarisë, Zhvillim Rural, Mjedis dhe planifikim hapësinor. "Ata as nuk kanë qenë të interesuar të përmirësojnë gjendjen apo t'i ndalin keqpërdorimet. Ndaj tani fjalën e ka Prokuroria Speciale", ka thënë deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Sali Zyba.

Ndërkaq Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka reaguar ndaj kallëzimit penal të Lëvizjes Vetëvendosje, duke theksuar se mbështetja financiare për fermerët nuk mund të njolloset me tendenca politike paraelektorale.

Kryeshefi i Telekomit takohet me drejtorin e policisë, temë diskutimi thellimi i bashkëpunimit

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, është takuar të premten me drejtorin e Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, me të cilin ka diskutuar për mundësinë e thellimit të bashkëpunimit me qëllim të fuqizimit të ndërsjellë ndërinstitucional. "Racionalizimi, mbikëqyrja dhe forcimi i shërbimeve, duke ofruar përkrahje të ndërsjellë, shfrytëzimin e kapaciteteve dhe avancimi i

shërbimeve me interes të përbashkët, ishin disa nga temat që u shtruan në takim. Telekomit është vlerë dhe pasuri e Kosovës. Ne jemi në shërbim të qytetarëve, duke ngritur besimin në shërbimet tona, në profesionalizimin dhe respektimin e ligjit, në veçanti në ngritjen e performancës dhe besueshmërinë për sektorët e ndjeshëm të shtetit tonë. Fuqizimi i Telekomit është edhe fuqizim i shtetit tonë", ka thënë Istrefi pas takimit.



Lluka: Nga viti 2020 Kosova do t'i kontrollojë kufijtë e vet energjetikë



PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, së bashku me ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Jean-Hubert Lebet, gjeneralin e Forcave Ushtarake të Zvicrës, Philippe Rebord dhe ministrin për Siguri të kantonit Wallis të Zvicrës, Frederic Favre, kanë vizituar termocentralin "Kosova A" si Termocentralin

më të vjetër i ndërtuar në vitin 1962.

Vizita është bërë me kërkesë të gjeneralit të forcave zvicerane Philippe Rebord, ku me këtë rast ministri Lluka është i vetmi qeveritar që ka takuar numrin një të forcave zvicerane.

Ministri Lluka së bashku me gjeneralin kanë bashkëbiseduar për sigurinë kombëtare të

furnizimit me energji si dhe për nevojat e vendit për investime në këtë sektor jetik për ekonominë e Republikës së Kosovës. Po ashtu, gjatë vizitës ministri Lluka e ka informuar gjeneralin Rebord dhe ministrin për Siguri, Frederik Favre, për pasuritë që ka Kosova, respektivisht rezervat e linjtit "Ne kemi Ligjin për Energji dhe Kosova është vendi i

tretë në Evropë për rezerva të linjtit", ka thënë ministri Lluka. Ministri Lluka gjithashtu ka bërë me dije se nga viti 2020 Kosova do t'i kontrollojë kufijtë e vet energjetikë duke përmendur transmissionin në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Duke folur rreth projekteve kapitale në fushën e energjisë, ministri Lluka ka përmendur ndërtimin e

Termocentralit "Kosova e Re", ndërsa ka njoftuar mysafirët për aplikimin në fonde të BE-së për ndërrimin e filtrave të Termocentralit "Kosova B". Gjenerali Rebord ka falënderuar ministrin Lluka për prezantimin e projekteve në fushën e energjisë duke shtuar se tashmë shihet se Kosova ka një plan afatgjatë në fushën e energjisë.

Përfaqësues të bizneseve dhe qytetarë kërkojnë përmbajtje nga premtimet elektorale karshi agjendës ekonomike

Përfaqësues të sektorit privat, Berat Rukqi, Skender Krasniqi dhe Lulzim Syla, kanë kërkuar nga politikanët të jenë të matur gjatë fushatës zgjedhore dhe mos ta zënë në gojë rritjen e pagave në sektorin publik dhe rritjen e punësimit. Qytetari Artur Krasniqi, i cili është i punësuar në sektorin privat që nga viti 2010, ka thënë se si rrjedhojë e rritjes së vazhdueshme të pagave në sektorin publik, punëtorët e sektorit privat janë detyruar të heqin dorë nga nevojat elementare në mënyrë që shteti t'ua sigurojë pagat punonjësve shtetërorë

shtetëror. Shihni çdo vit në tregun e punës hyjnë 30 mijë qytetarë, kurse në vitin e kaluar, karshi vitit 2017, kishim 10 mijë vende më pak të punës. Andaj, kur bëhet rritja e pagave duhet t'i dallojmë në bazë të viteve të shkollimit, e jo të marrë pagë të njëjtë si ai me shkollë të mesme si ai me fakultet. Rritja e pagave çdoherë është premtuar dhe bërë në sektorin publik, e që barrën për këtë e kanë vënë te bizneset dhe punëtorët e sektorit privat. Do të duhej të ndalej kjo praktikë", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se s'mund të thirrën edhe në respektim të Ligjit të Punës, pasi ka mos[per]puthje në mes të orëve të punës. "Respektimi i Ligjit të Punës që në letër shënon 40 orë pune në javë, në institucionet publike punohet vetëm 35 orë, prandaj duhet të jenë të saktë edhe në këtë drejtim. Po ashtu, kemi shumë udhëzime administrative që s'u përfillen e që do të kontribuonin në zhvillimin ekonomik. Zhvillimi ekonomik, zhvillimi i turizmit dhe prodhimtaria çdoherë ishin tema, por vetëm deklarata gojore", u shpreh Krasniqi. Edhe kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukqi, ka apeluar te lidërshipi që të jetë i matur dhe mos të japë premtime sa për vota. Ai ka kërkuar përmbajtje nga premtimet të cilat janë të parealizueshme dhe

pa një analizë të mirëfilltë e që, sipas tij, e rëndojnë edhe sektorin privat. "Assesi mos të ketë premtime për hapje të vendeve të punës kur s'ka qartësi se si mund të hapen. Mos të ketë premtime për rritje pagash, sidomos në sektorin publik dhe premtime për tërheqje të investimeve, që shpesh aludojnë në mrekulli. Në kohë fushatash ka eufori dhe shpesh s'përfilllet legjislativi i Kosovës", u shpreh ai. Sipas Rukqit, ideale do të ishte që spektri politik të dalë në fushatë elektorale me një marrëveshje politike karshi agjendës ekonomike. "Ideale do të ishte të kishte një pakt të partive politike, që mos të bëjnë asnjë premtim në fushatë zgjedhore gjatë punës së tyre në qeveri dhe kuvend që s'ka rezultate dhe dëmton qëndrueshmërinë financiare të shtetit, por edhe realisht bëhen edhe pengesë për zhvillimin e sektorit privat", u shpreh Rukqi. Po ashtu, i së njëjtës linjë të apelit është edhe njohësi i çështjeve të biznesit në vend, Lulzim Syla. "Apeluj që mos të dalim me premtime të rritjes së punësimit me shifra për të cilat s'kanë asnjë plan konkret, e që mbi bazë të punësimit do të ngrehej edhe zhvillimi ekonomik. Po ashtu, as rritja e pagave s'do të duhej të ishte premtim i programit të tyre, duke përfshirë këtu edhe liberalizimin e vizave që s'do të duhej

hiç ta përmendnin, pasi s'kishin gatishmërinë më të vogël për të dhënë një datë të saktë. Po ashtu, mos të thirrën as në cilësinë në arsim që, si rrjedhojë, ka çuar edhe në falimentime, pasi në momentin që s'ke njerëz të edukimit të mirëfilltë, ke konkurrencë të ashpër, e që mandej të dërgon edhe në falimentim", u shpreh Syla. Edhe qytetari Artur Krasniqi, i cili është i punësuar në sektorin privat që nga viti 2010, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se punëtorët e sektorit privat duhet të heqin dorë nga nevojat elementare që shteti t'i sigurojë pagat për punëtorët e sektorit publik e që, sipas tij, kjo s'mund të jetë zhvillim, por mjerim. "Tanimë u bënë hite premtimet e njëjta, por vendi zhvillohet kur ka infrastrukturë të mirëfilltë ligjore. Andaj, vetëm punësimet në sektorin publik s'janë zhvillim, por mjerim për shoqërinë. Rritja e pagave vetëm në sektorin publik pa dyshim se ndikon në mirëqenien e punëtorëve të sektorit privat dhe ne duhet të sakrifikojmë shumë për nevojat tona elementare, e mos t'i përmendim ato të luksit, në mënyrë që atyre shteti t'ua sigurojë pagat, apo rritjen e tyre. Rritja e mëturjes dhe pagave të tyre s'mund të mbrohet apo arsyetohet nga asnjë qeveri", u shpreh Krasniqi.

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 2 GUSHT - Përfaqësues të odave dhe asociacioneve ekonomike, Berat Rukqi nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe Skender Krasniqi nga Oda e Afarizmit të Kosovës, si dhe njohësi i çështjeve të biznesit, Lulzim Krasniqi, tanimë kur jemi në prag të shpërbërjes së qeverisë Haradinaj në detyrë, kanë kërkuar nga spektri politik që të përmbahen nga premtimet "megalomane" për fushatë parazgjedhore e që, sipas tyre, shkojnë në kurriz të ngarkesës financiare për bizneset, por edhe punëtorët e sektorit privat. Sipas

tyre, spektri politik duhet të jetë i matur dhe mos të premtojë rritje pagash në sektorin publik, rritje të punësimit, tërheqje të investimeve të huaja, ndalje të ikjes së trurit "brain drain", si dhe lëvizje të lirë të qytetarëve dhe bizneseve.

Kryetari i Odës së Afarizmit të Kosovës, Skender Krasniqi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se rritja e pagave dhe rritja e punësimit s'do të duhej që të ishin në agjendën e premtimeve elektorale. "Në çdo shtet normal në botë prioriteti i tyre është rritja e punësimit, e që më pas do të përcillej edhe me rritjen e pagave, kurse tek ne prioriteti është rritja e pagave në sektorin

THE MOST MISERABLE ECONOMIES

Isery Index Forecasts for 2019

1 Unemployment, annual % 2 Inflation, annual % 3 Misery Index, unemployment & inflation

Country	Misery Index
Venezuela	500.5
Zimbabwe	97.1
Argentina	52.0
Iran	42.2
Bosnia-Herz.	36.7
Nigeria	33.5
South Africa	32.8
Yemen	31.1
Kosovo	29.6
Turkey	29.0



Kryeqyteti do të bëhet me Sunny Hill Academy

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Komuna e Prishtinës dhe Sunny Hill Foundation kanë nënshkruar të premten marrëveshje bashkëpunimi për krijimin e Sunny Hill Academy në Prishtinë. Në këtë shkollë do të ketë instrumente dhe gjëra të tjera që nevojiten për talentët e rinj në Kosovë, që të mund të ushtrojnë aty. Dukagjin Lipa ka thënë se qëllimi i këtij fondacioni është që të rinjve dhe fëmijëve të Kosovës t'u ofrohet një hapësirë ku mund ta shprehin frymën artistike. "Jemi mbledhur këtu për një ngjarje pak më ndryshe se herën e kaluar. Qëllimi i fondacionit ka qenë të kemi një hapësirë që do të jetë në shërbim të të rinjve shqiptarë, në mënyrë që ta kthejmë atë frymën artistike të cilën, ndoshta, fëmijët e Prishtinës dhe Kosovës e

kërkojnë dhe dëshirojnë, ashtu siç e kemi pasur ne më përpara. Sot për ne është një konferencë me domethënie shumë të madhe", ka thënë ai. Ndërsa këngëtarja shqiptare me famë ndërkombëtare, Dua Lipa, ka pohuar se kjo ka qenë një ëndërr e madhe për të. "Faleminderit për mbështetjen e vazhdueshme. Kjo ka qenë një ëndërr e madhe për ne ku fëmijët dhe rina mund të vijnë këtu dhe ta shprehin talentin e tyre", ka deklaruar Dua Lipa. Ndërkaq kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka thënë se Dua Lipa është ambasadorja më e mirë e Prishtinës në botë. Ai ka bërë me dije se Sunny Hill Foundation së bashku me Komunën e Prishtinës do të investojë 150 mijë euro për realizimin e projektit Sunny Hill Academy.



Gashi: MKRS-ja do t'i mbështesë shtëpitë botuese dhe bibliotekat për furnizim me libra



FERIZAJ, 2 GUSHT (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka marrë pjesë të premten në Panairin e Librit në Ferizaj, i organizuar nga Klubi Letrar "De Rada". Me këtë rast, ministri Gashi tha se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të vazhdojë t'i mbështesë të gjitha shtëpitë botuese dhe bibliotekat për furnizim me libra. "Jam i lumtur që jam në Ferizaj për të

promovuar projekt të ri kulturor, një ngjarje të veçantë, organizimin e Panairit të Librit", ka thënë ministri Gashi, duke shtuar se MKRS-ja ndër prioritetet e veta ka përkrahjen e panairove të librit nëpër të gjitha qendrat regjionale të Kosovës. "Ne si MKRS ndër prioritetet tona kemi përkrahjen e panairove të librit nëpër të gjitha qendrat regjionale të Kosovës, ashtu që

libri dhe aktivitetet që nxisin dashurinë për librin, për leximin, të jenë më afër qytetarëve", është shprehur ministri Gashi. Ndërkaq kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka falënderuar ministrin Gashi për mbështetje, duke theksuar se ndihet i lumtur që Ferizajt iu shtua ky aktivitet i cili i kishte munguar këtij qyteti kulturor.

KEDS-i do të investojë katër milionë euro këtë vit në Ferizaj

FERIZAJ, 2 GUSHT (ER) - KEDS-i shumë shpejt do t'i nisë punimet për realizimin e 14 projekteve energjetike në Komunën e Ferizajt, që kapin një kosto prej 4 milionë eurosh. Kështu ka bërë me dije drejtori i Investimeve të KEDS-it, Hasan Oz, gjatë takimit me zyrtarët komunalë të Ferizajt, ku është arritur marrëveshja mes palëve. Sipas planit investiv, brenda në qytet do të ndërtohen linja të reja nëntokësore me qëllim të lidhjeve unazore mes trafostacioneve ekzistuese dhe pas përfundimit të nënstacionit nga ana e KOSTT-it, që pritet të përfundojë në vitin 2021, do të lidhet komplet rrejtja e KEDS-it. Ferizaj, pas Prishtinës, do të jetë qyteti i vetëm në Kosovë që do të ketë furnizim të dyfishtë në

formë unazore. Gjithashtu, do të bëhet edhe riparimi i disa trafove ekzistuese. Projektet pritet të përfundojnë në fund të këtij viti dhe për këtë KEDS-i ka angazhuar pesë kompani kontraktuese për kryerjen e punimeve në afat sa më të shkurtër kohor dhe pas kësaj Ferizaj do të ketë furnizim cilësor dhe 24 orë pa ndërprerë energji elektrike. Pas përfundimit të këtyre projekteve energjetike do të përfitojë komplet qyteti Ferizaj dhe fshatrat që përfshihen me largpërçuesin e kampit Bondsteel. Lulzim Aliu, drejtor i Urbanizmit dhe Mjedisit të kësaj komune, ka falënderuar KEDS-in për investimet në infrastrukturën energjetike të komunës së tij në të mirë të qytetarëve.



Miratohet rregullorja për shfrytëzimin e parkingjeve në Prishtinë

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Kuvendi Komunal i Prishtinës ka miratuar rregulloren për organizimin

dhe shfrytëzimin e parkingjeve në Prishtinë, duke hapur rrugë për vazhdimin e fazave të tjera të implementimit të

këtij projekti të rëndësishëm për kryeqytetin. Komuna e Prishtinës ka njoftuar se organizimi i mirëfilltë i park-

ingjeve është ndihmesë për lëvizshmërinë e të gjithë pjesëtarëve të komunikacionit.



Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (9)

ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

- Përshtypjet në "librin e zisë"



**Përgatiti: Selatin
NOVOSELLA**

Me respekt i madhi Baca Adem Demaçi! Lavdi!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Lavdi jetës dhe veprës madhështore të Adem Demaçit!

27 korrik 2018,
Rinia e PDK, Lipjan

Luan ishe në këtë jetë, na mësove të bëhemi të tillë! Legjendë do jesh deri në amshim!

27 korrik 2018,
Fahri Zebica

Lavdi Bacës, me faqe të bardhë!

27 korrik 2018,
D. M.

Përjetësisht LAVDI, njeriut, që shkriu çdo gjë si qiri, për atdheun e tij, Kosovën!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Lavdi, Bacës Adem!
Bacë, nuk je vdekur, bacë të shtrëngova dorën herët në Cyrih të Zvicrës, Bacë, të shtrëngova dorën edhe në Gostivar, atje ku bashkërisht me Gostivarasit NDEZE FLAUTËN E JANARIT!

Bacë, edhe sot qëndroj gatitu, për të marrë detyrat e reja...!
Lavdi o Bacë!

27 korrik 2018,
Luan Veliu, Gostivar

Lavdi Baca Adem!
Gjithmonë qofsh në zemrat tona!
Do jetësh përherë me ne!

27 korrik 2018,
Ceni, Gostivar

Lavdi e respekt Baci Adem! Do nderohesh përherë nga çdo atdhetar shqiptar, kudo që jeton.

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem, nuk kemi me të har-
rua asnjëherë! Lavdi!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Rilindësi i Shekullit të bashkimit kombëtar, i idealizmit, revolucionari i paepur! I tillë ishte Baca Adem Demaçi.

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Lavdi të pavdekshmit, Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Shemsedin Hoxha

Lavdi të pavdekshmit, Bacës Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Ismajl Rashiti

Jam me fat që jetova në Epokën Tëndë! Lavdi jetës dhe veprës se Kolosit, Bacës, Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Afrim Termkollit

Lavdi e përjetshme strategut dhe kolosit shqiptar, Bacës Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Sabri Rexha

Lavdi heroit, Nderit të Kombit, bacës Adem!

27 korrik 2018,
Elfete Rexhepi

Në mes të dy jetëve, zgjodhe jetën e përtejme! Ishe shembull se si luftohet e rezistohet për liri r demokraci. Këtë jetë ia fale kombit me sakrificë sublime, kurse tjetrën uroj t'ia falësh Zotit të parajsës!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem, Ti ike dhe fizikisht nuk do të jesh në mesin tonë, por sakrifica, vepra dhe vizioni yt do të jenë gjithmonë udhërrëfyes për brezat e ardhshëm, do të jenë model se si duhet ta duam atdheun dhe si duhet të sakrifikohe mi popull për atdhe.
I lehtë të qoftë dheu i Kosovës!
Lavdi!

27 korrik 2018,
Rexhep Tërshnjaku

Lavdi veprës dhe jetës së Adem Demaçit!

27 korrik 2018,
Nazmije (mbiemri i palexueshëm)

Krenar që të patëm, keq që të humbëm! Vepra jote është pavdekësi o Baca Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
E. Fetahu

Ti ishe dhe do të jesh "Baba i Kombit"! Lavdi për punën dhe veprën Tëndë!

27 korrik 2018,
Sejdi Lahu

Lavdi e përjetshme o burrë i madh i kombit, Hero i Kosovës! Ti Bacë dhe gjithçka nga vetja që vetëm të rrojë Kombi Shqiptar!

27 korrik 2018,
Ali Mehmeti, Besianë

I përjetshëm do të mbetet kujtimi për Ty Bacë! Vepruam dhe punuam me emrin Tënd deri në çlirim! Faleminderit për gjithçka dhe për kombin tonë!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Me fat është çdo njeri që jeton në planetin ku frymve Ti. Ne ishim me shumë fat. Zoti të shpërbleftë me të mirat e TIJ!

27 korrik 2018,
Besnik Berisha

Lavdi, Baca Adem!

27 korrik 2018,
Mehdi Sinani

Të mëdhenjtë nuk vdesin, ata vetëm ndërrojnë jetë. Lavdi, Bacë, Biri i Kombit!

27 korrik 2018,
Ramush Sinani

Në emër të familjes së Gjeneralit Shaban Shala, shprehim ngushëllimet më të sinqerta familjes së Legjendës së Kombit shqiptar, Adem Demaçit. Lavdi!

27 korrik 2018,
Elmi, Gani e Nuhi Shala

Lavdi veprës së Heroit tonë Kombëtar, Adem Demaçi! Ishim një grup njerëzish nga Reçaku për të nderuar veprën e madhe dhe të palodhur të Bacës Adem! Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës!

27 korrik 2018,
Afrim Jakupi me shokë, Reçak

Lavdi për jetë e mot, Bacë! Mburremi që të patëm!

27 korrik 2018,
Besim Dinolli, Pleshinë

Do të mbetesh shembull për shumë gjenerata të reja anë e mbanë tokave shqiptare! Lavdi!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

I përjetshëm qoftë kujtimi për Ty Daja im i dashur!

27 korrik 2018,
F. Tetovë



Lavdi o njeri i madh Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

I përjetshëm qoftë kujtimi për Ty, Daja Adem! Do të më mungosh! Me respekt përherë!

27 korrik 2018,
Nipi i Juaj

Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës, Daja Adem! Vepra dhe sakrificat jote nuk vdes kurrë! Lavdi!

27 korrik 2018,
Zgjim Shaini

Respekt të veçantë për Bacën, Adem Demaçi! Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës të cilën e deshe aq shumë!

27 korrik 2018,
Mifail Xhemajli

Ngushëllime Kombit Shqiptar... Baca Adem do të frymojë i gjallë sa të ketë jetë në trojet tona shqiptare!

27 korrik 2018,
Ilmije Ali Rexha

Ishe dhe mbetesh frymëzues brezash! Një në kombin shqiptar, shembull për njerëzimin!

27 korrik 2018,
Jeton A. Rexha

Lavdi jetës dhe veprës së pavdekshme të Bacës Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Agim (mbiemri i palexueshëm)

Ngushëllimet më të thella nga zemra për Bacën Adem, luftëtarin monumental të çështjes kombëtare dhe simbolin e lirisë dhe të qëndrësës kombëtare, kolosin e kombit, të virtyteve dhe vlerave universale!

27 korrik 2018,
Naim Zymberi

Ngushëllime familjes së madhe DEMAÇI! Veprat e Tij janë të pavdekshme për ne të gjithë shqiptarëve të Kosovës! I qoftë i lehtë dheu i Kosovës për të cilën e sakrifikoi tërë rininë e vet!

27 korrik 2018,
Nexhmije Gecaj, Prapashtica

Ngushëllime për familjen dhe të afërmit, për njeriun që një e jetë e sakrifikoi për lirinë e vendit dhe të popullit të tij, dhe për fat e pritë lirinë! Vepra jote s'mund të harrohet!

27 korrik 2018,
(emri i palexueshëm) Gecaj

E adhuroja pa masë Skënderbeun, Gjyzepe Garibaldin, Ymer Prizrenin, që punuan për bashkimin Kombëtar!
Ti ndoqe rugën e tyre dhe na le amanet të punojmë deri në Bashkimin Kombëtar!

27 korrik 2018,
Jakup Mazreku, Malishevë

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)

Trumpi dhe Johnsoni zhvillojnë bisedën e dytë telefonike brenda një jave

UASHINGTON, 2 GUSHT - Presidenti amerikan, Donald Trump, dhe kryeministri i ri britanik, Boris Johnson, kanë diskutuar për tregtinë dhe përpjekjet në rritje për të kontrolluar teknologjinë 5G, njoftoi Shtëpia e Bardhë. Trumpi dhe Johnsoni, gjatë bisedës telefonike, përmendën

bashkëpunimin dypalësh, veçanërisht në fushën e tregtisë dhe sigurisë botërore. Kjo është biseda e dytë telefonike Trump-Johnson, brenda një jave, duke nënvizuar mbështetjen e administratës amerikane, për kryeministrin e ri britanik.

Presidenti amerikan ka përsëritur se ai respekton lidhjet speciale mes dy vendeve, duke shtuar se mezi pret të takojë Johnsonin, në fund të gushtit, në marginat e një samiti të grupit të shtatë vendeve më të industrializuara - G7 që do të mbahet në Francë.



ShBA-ja tërhiqet nga traktati i forcave bërthamore

Pasi që Moskë refuzoi t'i shkatërrojë raketat e reja të prodhuara prej saj, për të cilat NATO-ja thotë se shkelin paktin, Shtetet e Bashkuara u tërhoqën të premtën nga traktati i Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme Veprimi

UASHINGTON, 2 GUSHT - Shtetet e Bashkuara u tërhoqën të premtën nga traktati i Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme Veprimi (INF) pasi Moskë refuzoi t'i shkatërrojë raketat e reja të prodhuara prej saj, për të cilat NATO-ja thotë se shkelin paktin. "Rusia nuk arriti t'i rikthehej pajtueshmërisë së plotë e të verifikueshme përmes shkatërrimit të sistemit të ri të raketave që nisen nga toka (SSC-8 ose 9M729), me rreze të mesme veprimi", tha në një deklaratë sekretari i Shtetit, Mike Pompeo. "Përgjegjësia për prishjen e traktatit është vetëm e Rusisë", shtoi ai. Pompeo tha gjithashtu se Shtetet e Bashkuara "nuk do të jenë palë e një traktati që është shkelur qëllimisht nga Rusia. Mosrespektimi nga Moskë e kushteve të këtij pakti rrezikon interesat kryesore të ShBA-së pasi prodhimi dhe dislokimi i një sistemi raketash që shkel traktatin, paraqet një kërcënim të drejtpërdrejtë për Shtetet e Bashkuara, aleatët dhe partnerët tanë". Të enjten presidenti amerikan



Donald Trump tha se shpresonte në arritjen e një marrëveshjeje të re për ta zëvendësuar paktin historik të periudhës së Luftës së Ftohtë. "Rusia kërkon të bëjë diçka me traktatin bërthamor dhe unë nuk kam kundërshtim. Ata do të donin të bënin diçka dhe unë gjithashtu", tha Trumpi duke iu përgjigjur një pyetjeje të "Zërit të Amerikës" të enjten pasdite. Por duke folur në ambientet e jashtme të Shtëpisë së Bardhë përpara se të hipte në helikopterin presidencial, Trumpi tha se "nuk kishte diskutuar rreth traktatit të Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme

Veprimi" gjatë një bisede që kishte pasur një ditë më parë me presidentin rus Vladimir Putin. Gjatë deklaratës së tij, Pompeo i bëri thirrje Rusisë dhe Kinës "t'i bashkohen mundësisë për të dhënë rezultate reale në fushën e sigurisë për vendet e tyre dhe për të gjithë botën". Me skadimin e traktatit, bota humbet "një mekanizëm të paçmueshëm që frenon luftën bërthamore", u tha gazetarëve të enjten sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres. "Kjo ka të ngjarë të rrisë dhe jo ta zvogëlojë kërcënimin që paraqesin raketat balistike", tha ai.

Për muaj të tërë zyrtarët amerikanë kanë shprehur pakënaqësinë që Rusia nuk i dëgjoji thirrjet e zyrtarëve në Uashington dhe në Evropë për t'i dhënë fund shkëljes së traktatit. Zyrtarët rusë pretendojnë se ata i kanë respektuar rreptësisht kushtet e traktatit dhe nuk kanë lejuar shkelje. Një muaj më parë presidenti rus Vladimir Putin nënshkroi ligjin që pezullonte pjesëmarrjen e vendit të tij në traktat, pesë muaj pasi administrata Trump ndërmoi një hap të ngjashëm. Pakti ka qenë një shtyllë për sigurinë evropiane për më shumë

se 30 vjet. Ai ndalon prodhimin dhe dislokimin e raketave bërthamore me rreze veprimi prej 500 në 5 500 kilometra. Udhëheqësit evropianë, duke iu frikësuar një gare të re armatimi me prishjen e traktatit, i kanë bërë thirrje Uashingtonit dhe Moskës të qëndrojnë të angazhuar në mënyrë konstruktive në përpjekje për ta ruajtur atë. Marrëveshja e vitit 1987 u nënshkrua nga presidenti amerikan Ronald Reagan dhe udhëheqësi sovjetik Mikhail Gorbachev. Falë saj, dy vendet u angazhuan ta eliminojnë arsenalin e raketave me rreze të mesme veprimi.

Koreja e Veriut, prova të reja me raketa

PHENIAN, 2 GUSHT - Koreja e Veriut lëshoi të premtën dy raketa në brigjet e saj lindore, në raundin e tretë të provave të armëve në pak më shumë se një javë. Njoftimi u bë nga Ushtria e Koresë së Jugut. Aktiviteti i shtuar i provave shihet si një taktikë që synon rritjen e presionit ndaj Seulit dhe Uashingtonit mbi negociatat e bllokuara bërthamore. Vetë Koreja e Veriut ka shprehur shqetësim rreth manovrave ushtarake të planifikuara mes ShBA-së dhe Koresë së Jugut.

Ekspertët thonë se provat me raketa mund të shtohen në muajt e ardhshëm nëse nuk bëhet përparim në negociatat bërthamore. Zyra e presidentit të Koresë së Jugut njoftoi se këshilltari kryesor për sigurinë kombëtare Chung Eui-yong zhvilloi një takim urgjent me ministrat e qeverisë për të diskutuar rreth zhvillimeve të fundit. Kim Eun-han, një zëdhënës i Ministrisë së Unifikimit të Koresë së Jugut, tha se Qeveria e Seulit shprehu "keqardhje të thellë" për provat me armë dhe men-

don se ato mund të ndikojnë negativisht në përpjekjet për të vendosur paqe në Gadishullin Korean. Ministria e Mbrojtjes e Japonisë njoftoi se raketat nuk kishin arritur në ujërat territoriale japoneze apo në zonën e saj ekskluzive ekonomike. Më 25 korrik Pheniani lëshoi një raketë balistike me rreze të shkurtër veprimi, ndërsa të mërkurën kreu atë që u cilësua si provë me një sistem të ri të aftë për të lëshuar shumë raketa.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E jashtëzakonshme

I shpëtoi jetën, pitoni e "përqafoi" për vdekje

Një roje pylli në Indi shpëtoi për mrekulli pasi një piton i madh u përpoq që ta mbyste pasi roja i kishte shpëtuar pak më parë jetën atij. Kur po pozonte për një foto me pitonin, gjarpri 10 metra i gjatë nisi t'i mblidhej rreth qafës rojës indian. Në këtë çast rojën e zuri paniku dhe nisi të vraponte duke u munduar që ta lironte "përqafoimin" e pitonit, ndërkohë që ndërhyjnë dhe kolegët e tij për ta "zbërthyer" pitonin.



FOTO E DITES



Ky imazh ajror tregon anijet peshkimi në ditën e fundit të moratoriumit të peshkimit veror në provincën Jiangsu të Kinës. Fotografia: AFP, publikuar në Zërin e Amerikës.

E rrallë

Turisti i dehur thyen rregullat për një xhiro me gjirafë

Një vizitor i dehur në kopshtin zoologjik në Kazakistan është përpjekur të bëjë xhiro me gjirafë. Në rrjetet sociale po qarkullojnë pamjet ku burri shihet duke kaluar gardhin e sigurisë dhe duke hipur në qafën e gjirafës. Nuk ia doli të



qëndronte gjatë në qafë dhe përfundoi në shpinë por, me disa lëvizje të kafshës, burri u rrëzua në tokë. Thuhet se nuk ka pësuar lëndime. Ndërkohë policia është në kërkim të tij pasi ka bërë një veprim të ndaluar dhe do të merren masa për të.

BARSOLETA E DITËS



Plaku mbush 90 vjet, shqiptarët komentojnë: Edhe 100 vjet të tjera të lumtura!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30 "Spider-Man Far From Home" 3D,

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 09 min
Rolet: Tom Holland, Samuel L. Jackson, Zendaya, Cobie Smulders, Jon Favreau, JB Smoove, Jacob Batalon, Martin Starr, Marisa Tomei, Jake Gyllenhaal

Regjia: Jon Watts



Çdo ditë në ora 17:30

"THE LION KING" 3D

Aventurë/Dramë; 1 orë 58 min

Rolet: Donald Glover, Seth Rogen, Chiwetel Ejiofor, Beyoncé Knowles-Carter, James Earl Jones, Alfre Woodard, John Oliver
Regjia: Jon Favreau



Në ora 19:30 dhe 22:00

"HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.
Regjia: David Leitch




Nga dt. 08.08.2019

"THE ANGRY BIRDS MOVIE 2"

Horror/Triller; 1 orë 39 min

Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj

Regjia: Thurop Van Orman



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Nëse doni ta rrisni vetëbesimin e dikujt, është mirë ta merrni dhe të diskutoni me të me qetësi për ngjarjet e fundit që i kanë ndodhur.</p>	 <p>DEMI Sot do të rriteni shpirtërisht duke dëgjuar muzikë të mirë dhe duke ndenjtur në ambiente intelektuale që kishin kohë që ju mungonin.</p>	 <p>BINJAKËT Nëse keni marrë përsipër të përshkoni një rrugë të caktuar nuk duhet të keni më mëdyshje. Çdo kthim pas do t'ju kushtojë.</p>	 <p>GAFORRJA Shumë objektiva tuajat po i anashkaloni vetëm për një hutim të çastit. Do të jetë më mirë të kërkoni këshilla te personat e duhur.</p>	 <p>LUANI Po ju jepen shumë mundësi në karrierë dhe jeni të dyzuar ndërmjet oportuniteteve që do të zgjidhni. Kërkoni mendimin e familjes.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Çdo gjë po shkon më së miri nga ana sentimentale. Ju ndiheni në qiellin e shtatë nga një dhuratë që jua ka bërë partneri.</p>
 <p>PESHORJA Momenti më i mirë i ditës suaj është mëngjesi. Keni kohë të mendoni për çdo gjë dhe jeni më produktiv dhe energjik.</p>	 <p>AKREPI Duhet t'i shfrytëzoni informacionet e reja që do të merrni dhe nuk keni pse merrni kohë që të mendoheni. Çdo gjë ka për të shkuar siç e keni vendosur.</p>	 <p>SHIGJETARI Sot po reflektoni mbi çështje që më parë ju janë dukur shumë të thjeshta. Keni anashkaluar gjëra të rëndësishme që tashmë janë bërë probleme.</p>	 <p>BRICJAPI U bë disa kohë që një person i caktuar po ju bezdis lidhur me një temë që ju nuk dëshironi ta prekni. Sot do të tregoheni shumë i prerë.</p>	 <p>UJORI Sot do të keni surpriza pozitive dhe negative. Keni lënë për shumë kohë pezull një situatë që tashmë ka degjeneruar.</p>	 <p>PESHQIT Edhe pse në ambientin e punës mund të keni probleme të vogla, personat që ju rrethojnë, nuk kanë qëllime negative karshi jush.</p>

Zbulohet zyrtarisht shkaku i vdekjes së Cameron Boyce



Shkaku i vdekjes së Cameron Boyce është konfirmuar zyrtarisht. Ylli 20-vjeçar vdiq për shkak të një konfiskimi masiv epileptik, sipas "The Blast". Vdekja e tij e papritur u lidh me epilepsinë, sipas policisë. Ai ishte diagnostikuar tre vjet më parë dhe tashmë kishte pësuar konfiskime të mëdha ndër vite. Thuhet se ai po merrte Keppra për t'u trajtuar. Cameron u gjet i vdekur më 6 korrik në shtëpinë e vet në Los Anxhelos.

Catherine Zeta Jones dhe Michael Douglas, për pushime në Evropë



Catherine Zeta Jones dhe Michael Douglas po shijojnë ca ditë pushimi jashtë shtetit të tyre. Aktorja 49-vjeçare dhe aktori 74-vjeçar u panë dorë për dorë duke zbritur nga një varkë, ndërsa arritën

në një restorant në Portofino, Itali. Një ditë më parë çifti ishte në Francë. Muajin e kaluar Catherine Zeta Jones dhe Michael Douglas ishin pjesë e "Enigma's Show" të Lady Gaga në Nju Jork.



Kerry Katona në gjyq për shkak se nuk dërgoi fëmijën në shkollë

Kerry Katona do të gjyko-
het pasi dyshohet se nuk
e ka dërguar në shkollë
njërin prej fëmijëve. Këngëtarja
britanike është akuzuar se nga
31 tetori deri më 28 nëntor të
vitit të kaluar nuk e ka dërguar
fëmijën në mësim, shkruajnë
mediat e huaja. 38-vjeçarja ka
mohuar akuzat e ngritura ndaj

saj. Asaj i është thënë se në
tetor të këtij viti do të përballlet
me gjykatën. Mbrojtësi ligjor i
saj, Jason La Corbiniere, ka
thënë se nuk bëhet fjalë për
ndonjë ngatërrësë me
këngëtares dhe fëmijës, por që
nuk ka mundur ta dërgojë atë
në shkollë për shkak të
sëmundjes.

Lena Dunham shfrytëzon rastin dhe puth Brad Pittin



Lena Dunham ka thënë se ka
filtruar me yllin Brad Pitt në
grupin e Quentin Tarantino në
filmin "Once Upon a Time in
Hollywood", por krijuesi i "Girls" i
ka çuar gjërat në tjetër nivel gjatë
premierës së filmit në Londër. Kur

kasta u rreshtua në tapetin e kuq,
Dunham u nda prej Pittit nga
Tarantino dhe yjet e famshëm Leo
DiCaprio dhe Margot Robbie. Por
ajo sërish arriti te Brad dhe i dha
një puthje në buzë. Në film ajo luan
një ndjekëse të Charles Mansonit.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Feronikeli shkarkon Ramadanin, Sokoli në opsion

Dy humbjet nga Slovan Bratislava dhe eliminimi nga Liga e Evropës kanë qenë vendimtare për të ardhmen e trajnerit Zekirija Ramadani, i cili është shkarkuar nga KF Feronikeli. "Zekirija Ramadani nuk do të jetë më trajner i KF Feronikelit. Kështu është vendosur pas një mbledhje të klubit me presidentin Naser Ramaj", thuhet në njoftimin e skuadrës së "Niklit"

EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 GUSHT - Eliminimi nga Liga e Kampioneve, më pas edhe nga Liga e Evropës, duket se kanë vendosur të ardhmen e trajnerit Zekirija Ramadani, i cili është shkarkuar të premtën nga detyra e trajnerit në KF Feronikeli. Suksesi i dyfishtë në rrafshin vendor duket se u "harrua" shpejt nga presidenti i Feronikelit, Naser Ramaj, i cili ka dhënë dritën jeshile për largimin e strategut nga Shkupi. "Zekirija Ramadani nuk do të jetë më trajner i KF Feronikelit. Kështu është vendosur pas një mbledhje të klubit me presidentin Naser Ramaj, duke analizuar gjendjen e klubit dhe rezultatet e fundit. Ramadani u shpall kampion i Kosovës me Feronikelin duke arritur ta rrëmbejë edhe Kupën e Kosovës dhe, sipas rregullave të FFK-së, ai ka fituar me automatizëm edhe Superkupën. Si klub e falënderojmë për bashkëpunimin korrekt dhe i dëshirojmë shumë sukses në vazhdimin e karrierës", thuhet në njoftimin e skuadrës nga Drenasi.

Si për ko incidencë, trajnerit Ramadani e njëjta gjë i kishte ndodhur edhe dy vjet më parë kur e drejtoi Trepçën '89 drejt titullit kampion në Kosovë dhe pas eliminimit nga garat ndërkombëtare u shkarkua. Trajneri Ramadani largimin nga Feronikeli e ka arsyetuar me përfundimin e kontratës, kurse gazeta ka mësuar se kampionët e Kosovës janë duke kërkuar trajnerë nga jashtë Kosovës, por që në opsion është edhe Bylbyl Sokoli.



gettyimages
James Baylis - AMA

Bisedimet me drejtuesit e skuadrës nga Drenasi duket se janë bërë shkas që trajneri nga Rahoveci të largohet nga skuadra e Ferizajit, me të cilën arriti një sukses të madh

edicionin e kaluar, pasi e mori drejtimin e kësaj skuadre në muajin janar dhe arriti që me një punë të madhe ta sigurojë mbijetesën në IPKO Superligë.

SHKURT

Karateistët fitojnë medaljen e bronzë në Kroaci

Ekipi i karatesë së Kosovës e ka fituar medaljen e bronzë në garat ekipore të Kampionatit Evropian të Universiteteve për sportet luftarake që po mbahet në Zagreb të Kroacisë. Karateistët e Kosovës, të përbërë nga studentët e Universitetit të Prishtinës, Benjamin Shabani, Dren Hajdari dhe Valdrin Rashiti, fituan medaljen në disiplinën kumite. Ata mposhtën ekipet e Spanjës, Serbisë dhe Francës. Evropiani është duke u organizuar nga Federata Evropiane e Sporteve Universitare (EUSA), kurse Federata e Sporteve Universitare e Kosovës (FSUNK) është duke u përfaqësuar me ekipe të karatesë dhe taekwondosë.

Ballkani transferon Bleon Sekiraqën

Skuadra e Ballkanit nga Suhareka vazhdon të bëjë përforsime për edicionin e ri futbollistik, kurse sot ky klub e ka zyrtarizuar transferimin e talentit Bleon Sekiraqa, i cili ka nënshkruar kontratë trevjeçare me Ballkanin. "Bleon Sekiraqa është futbollist i ri i FC Ballkani, duke firmosur bashkëpunimin trevjeçar me klubin e ri dhe sfidën e re. Deri me tani pjesën dërmuese të karrierës e ka kaluar në FC Prishtina, duke i kaluar të gjitha grupmoshat ku edhe ka bërë stërvitje me trajnerë të shquar të futbollit kosovar dhe të huaj. Presim nga Bleoni t'i ndjekë hapat e shokëve të tij si Blend Bafiu dhe Arbër Hoxha", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

Rahoveci prezanton Tsourakis

KB Rahoveci e ka transferuar qendrën greke Rafail Tsourakis. Tsourakis është përforsimi i tretë me radhë i huaj për nënkampionin e Kosovës në basketboll. Kujtojmë se përforsimi i parë i huaj për "vreshtarët" ishte alo-qendra kroate Jure Gunjina (204 cm) dhe përforsimi i dytë ishte amerikani Justin Gray (198 cm), 24 vjeç, i cili ka luajtur në Angli tek Bristol Flyers. Po ashtu, edhe plejmekekeri Leonard Mekaj, i cili në edicionin e fundit ka qenë pjesë e Golden Eagle Yllit, është konfirmuar te Rahoveci.

Llapi e rikthen Halitin në vendlindje

Qendërmbrojtësi shtatlartë Taulant Haliti ka nënshkruar kontratë profesionale me Llapi. Haliti i bashkohet vargut të shumtë të futbollistëve të rinj që premtojnë shumë në të ardhmen, andaj klubi ka vendosur për pesë vjet ta mbaj nën "petkun premtues". 18-vjeçari i lindur në Podujevë ka qenë pjesë e KF Ramiz Sadikut, ku u shpall kampion në regionin e Prishtinës dhe kampion i Kosovës. Taulanti u shpall futbollisti më i mirë në vitin e kaluar për kategorinë U-17 të Kadetëve.

Bekaj në Hoffenheim

PRISHTINË, 2 GUSHT - Portieri i Përfaqësueses së Kosovës, Visaj Bekaj, e mbylli pak javë më parë bashkëpunimin me klubin e Prishtinës. 22-vjeçari do të bëjë një hap gjigant duke u transferuar te klubi i njohur gjerman TSG

Hoffenheim. Kjo lëvizje që pritet të zyrtarizohet në ditët në vazhdim është mundësuar nga vetë kreu i klubit prishtinas Remzi Ejupi. Bekaj ka qenë prej disa sezonesh një ndër portierët më të dalluar në IPKO Superliga

e Kosovës dhe pjesë e rregullt e grumbullimeve të Bernard Challandes në përfaqësuesen e Kosovës. Nëse transferimi kryhet me sukses, duhet përmendur se Bekaj do ta nisë si portier i tretë, pas titullarit të

padiskutueshëm Oliver Bauman dhe portierit tjetër Filip Pentke. Me shumë gjasa aktivizimet e para të portierit shqiptar do të jenë me ekipin B të Hoffenheimit, që militon në Ligën Rajonale gjermane.



Maguire, mbrojtësi më i shtrenjtë në histori

MANCHESTER, 2 GUSHT - Manchester Unitedi ka arritur më në fund marrëveshje me Leicester Cityn për shërbimet e Harry Maguire. "Gjiganti" i mbrojtjes do të transferohet në "Old

Trafford", ndërsa Leicesteri do të përfitojë 85 milionë sterlina (93 milionë euro), derisa asnjë mbrojtës nuk kishte kushtuar kaq shumë më parë. Marrëveshja mes palëve është arritur dhe

diçka e tillë është bërë publike nga "The Telegraph". 26-vjeçari, i cili është edhe titullar i kombëtares angleze, do t'i kryejë të shtunën vizitat mjekësore dhe më pas do ta firmosë kontratën e re

me "Djajtë e kuq". Maguire bëhet mbrojtësi më i shtrenjtë në histori, duke ia kaluar edhe Van Dijkit, për të cilin Liverpooli pagoi 84.5 milionë euro më pak në verën e vitit 2017 te Southamptoni.



Berisha dhe Rrahmani kërkojnë ndihmën e tifozëve në Evropian

PRISHTINË, 2 GUSHT - Vashat e Kosovës U20 kërkojnë ndihmën e tifozëve për një paraqitje sa më të mirë në Evropianin historik që zhvillohet në Prishtinë. Kjo është hera e parë që një Kampionat Evropian i Divizionit B organizohet në Kosovë.

Për përgatitjet dhe pritshmëritë në këtë evropian kanë folur dy basketbollistët e Kosovës U20, Yllka Berisha dhe Agnesa Rrahmani. "Jemi munduar të përgatitemi maksimalisht për Evropianin që zhvillohet në Prishtinë. Kemi stërvitur dy herë në ditë dhe të shpresojmë në paraqitje sa më mirë në këtë evropian", është shprehur Berisha. "Ne jemi vasha të reja dhe synojmë të fitojmë përvojë në këtë evropian që zhvillohet në shtëpinë tonë. Përgatitjet kanë shkuar mirë dhe atmosfera ka qenë shumë e mirë", ka thënë Rrahmani. Moshë mesatare në ekipin e Kosovës është 17 vjeç dhe kjo tregon se janë më të reja se kundërshtarët e tyre në fushë. "Ne jemi vasha të reja, por angazhimi ynë nuk do të mungojë. Nuk kemi synime të mëdha, por shpresojmë në paraqitje të mira", ka shtuar Yllka Berisha. "Jemi në një grup shumë të vështirë, ku do të ballafaqohemi me shtete të



fuqishme të basketbollit siç janë Turqia dhe Rumania. Megjithatë, ne do të japim më të mirën në fushë", deklaroi Agnesa Rrahmani. Ato kanë folur për rëndësinë që ka evropiani në Prishtinë dhe u kanë bërë thirrje tifozëve t'i përkrahin. "Ne jemi të motivuara për këtë evropian që është historik për basketbollin e femrave dhe rritjen e basketbollit në konkurrencën e femrave. Shpresojmë se do ta kemi

ndihmën e publikut, sepse ai është shumë i rëndësishëm për ne në fushë. Është motivi ynë", kanë thënë njëzëri Yllka Berisha dhe Agnesa Rrahmani. Ndeshja e parë e Kosovës është të shtunën ndaj Turqisë nga ora 19:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Bileta ditore kushton 1 euro, kurse të gjitha të hollat do të jepen donacion për fëmijët e prekur nga sëmundja e fibrozës cistike.

Përballja Joshua - Ruiz nuk do të zhvillohet në ShBA

LONDËR, 2 GUSHT - E gjithë bota e boksit është në pritje të përsëritjes së duelit midis Anthony Joshuas dhe Andy Ruiz. Boksieri anglez ka zgjedhur që të kthehet në "bazën" e tij për ndeshjen e dytë, duke refuzuar të rikthehet në ShBA, ku pësoi humbjen e parë të karrierës së tij. Në një intervistë për "IFL TV", promotori i Joshuas, Eddie Hearn, zbuloi se dueli ka shumë gjasa të zhvillohet në Londër ose Cardiff. Një lajm i mirë ky për të gjithë fansat e boksit në Evropë, që s'do u duhet të presin deri në orët e para të mëngjesit për të shijuar spektaklin që ofron boks i peshave të rënda. "Në dy ditët e ardhshme do t'i njoftojmë përfaqësuesit e Andy Ruiz. Çka mund të them tani është se dueli nuk do të zhvillohet në ShBA. Po mendojmë disa vendndodhje të ndryshme. Natyrisht që shanset më të mëdha janë që të zgjedhim një stadium në Mbretërinë e Bashkuar. Ndoshta në Londër ose Cardiff. Ekziston edhe



një mundësi e vogël e zhvillimit të eventit në një vend neutral, pra jashtë Mbretërisë së Bashkuar, por kjo do të kërkojë shumë punë. Ndoshta Ruiz s'do ta pëlqejë këtë

gjë, por në kontratën e firmosur nga vetë ai është e qartë që kushtet për përsëritjen e duelit vendosen vetëm nga ne dhe jo nga ai", ka përfunduar Hearn.

SHKURT

Mbappe kundër largimit të Neymarit

Sulmuesi Kylian Mbappe është shprehur kundër largimit të Neymarit nga Paris Saint-Germain. "Dua që Neymar të mbetet me ne. Nuk dua që ai të largohet. Unë ia kam thënë këtë Neymarit", ka thënë Mbappe. Ylli brazilian është lidhur me një rikthim te Barcelona, kurse interesim për shërbimet e tij kanë shfaqur edhe Real Madridi dhe Juventusit.

Alvesi në Sao Paulo

Kapiteni i Kombëtares së Brazilit, Dani Alves, karrierën do ta vazhdojë në vendlindje, përkatësisht në klubin e Sao Paulos. 36-vjeçari i bashkohet skuadrës braziliene si lojtar i lirë, pasi kontrata me Paris Saint-Germainin përfundoi në muajin e kaluar. "Daniel Alves është mishërimi i planeve që ne drejtuesit e klubit i kemi menduar për Sao Paulon. Ai është një ndër lojtarët kryesorë në botë dhe është i njohur për profesionalizmin e tij. Ai është përjetësisht i etur për trofe dhe fitore dhe është i interesuar për vendin tonë. Kështu që, Sao Paulo fiton në të gjitha frontet e mundshme. Një ditë unë i thashë atij se do të vinte të luaj në Sao Paulo, klubin e zemrës së tij. Sot e kam kënaqësinë e madhe dhe krenarinë që ta përmbush këtë premtim", ka thënë presidenti i klubit, Carlos Augusto de Barros e Silva.

Dani Alves gjatë karrierës së tij ka luajtur për Bahian, Sevillan, Barcelonën, Juventusin dhe PSG-në.

Van de Beek, transferimi i gjashtë i Realit

Real Madridi, pas Eden Hazardit, Luka Joviçit, Ferland Mendyt, Rodrygos e Eder Militaos, ka arritur marrëveshje për transferimin e Donny van de Beek nga Ajaxi. E përditshmja spanjolle "Marca" ka raportuar se marrëveshja në mes të Realit dhe skuadrës holandeze është arritur, kurse Van de Beek do të zyrtarizohet gjatë javës së ardhshme. Ky transferim do t'i kushtojë Realit 50 milionë euro.

Dybala refuzon kalimin në 'Old Trafford'

Paulo Dybala e ka refuzuar ofertën e Manchester Unitedit. Sulmuesi argjentinas e ka njoftuar skuadrën e Juventusit se nuk dëshiron që të transferohet në "Old Trafford", njofton "La Gazzetta dello Sport". Ishte prituri që dy klubet në fjalë, United dhe Juve, të përfshijnë në marrëveshje për kalimin e Dybalas në Angli sulmuesin Romelu Lukaku, i cili parimisht është pajtuar që t'i bashkohet "Zonjës së Vjetër". Mirëpo refuzimi i Dybalas u ka hapur probleme të reja klubeve në fjalë.

Rivaldo: Reali nuk ka nevojë për Pogban apo Eriksenin

Ish-lojtari i Barcelonës dhe Kombëtares së Brazilit, Rivaldo, është i mendimit se skuadra e Real Madridit nuk ka nevojë për transferimin e mesfushorëve Paul Pogba (Manchester United) dhe Christian Eriksen (Tottenham Hotspur). "Shtypi thotë se Real Madridi duhet ta forcojë mesfushën me Christian Eriksen dhe Paul Pogba në mesin e objektivave të përfolur. Të dy janë lojtarë të shkëlqyeshëm dhe do të përshtaten mirë në 'Bernabeu'. Por, përkundër sezonit të tyre të keq, nuk jam i sigurt se Reali ka nevojë për përforsime. Nuk duhet të harrojmë se Casemiro sapo ka ardhur nga dëmtimi dhe ata kanë luajtur pa një prej lojtarëve më me impakt në ekip. Reali do të përmirësohet me Casemiron në skuadër, megjithëse mungesa e tij nuk shpjegon parasezonin e tyre të tmerrshëm", ka thënë Rivaldo.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
Agencija sa Upravljanje Memorialni Kompleksa Kosova
Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo

Form. MAP- SHCK-02
Obraz. MJU-CSK-02



SHPALLJE E REKRUTIMIT / OGLAS ZA REGRUTACIJU

Institucioni/Institucija: AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS (AMKMK), kërkon të punësojë në AMKMK: / AGENCIJA SA UPRAVLANJE MEMORIALNI KOMPLEKSA KOSOVA-(AUMKK) nastoji da zaposli u AUMKK:

Titulli i vendit të punës / Naziv radnog mesta:

- Zyrtar për Buxhet dhe Financa 1 - BF/270 / JP00040092 - (1 pozitë)
- Službenik za budžet i finansije 1 - BF / 270 / JP00040092 - (1 pozicija)

Departamenti/Divizioni

- Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme/Divizioni për Buxhet dhe Financa
- Odeljenje za finansije i opšte usluge / Odeljenje za budžet i finansije

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës/Funksionalna kategorija i stepen radnog mesta:

- Niveli profesional, koeficienti i pagës 7 / Struka Profesionalna, koeficijent plate 7

Vendndodhja e pozitës: Prishtinë/Priština

Numri i referencës së vendit të punës/ Broj preporuke za radno mesto: RN00005331

Detyrat dhe përgjegjësitë / Poslovi i odgovornosti:

- Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planin e punës dhe afatet me udhëheqësin dhe stafin tjetër profesional për planifikimin e buxhetit;
- Merr pjesë në hartimin e planeve buxhetore vjetore të institucionit, dhe ndihmon zyrtarët përkatës brenda institucionit për të siguruar që planet kompletohen me përpikëri dhe sipas afat;
- Kujdeset për përcjelljen e gjendjes së buxhetit në free-balanc, monitorimin e shpenzimeve të buxhetit gjatë vitit dhe përgatit raporte lidhur me shpenzimin e buxhetit;
- Evidenton faturat për pagesën e projekteve dhe pagesave në regjistrin përkatës dhe kujdeset për procedimin e tyre me kohë për ekzekutimin e pagesë;
- Mbledh dhe sistemon propozimet buxhetore dhe në bashkëpunim me zyrtarin e lartë shqyrton korrektësinë, saktësinë e propozimeve;
- Kujdeset për plotësimin e obligimeve të organizatës buxhetore, duke përfshirë këtu pagesën me kohë e faturave për realizimin e procedurave të prokurimit dhe pagesave;
- Mban evidencë për pagesën e lëndëve lidhur me udhëtimet zyrtare jashtë vendit - për avance të udhëtimeve zyrtare;
- Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkojnë kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

☒ Razvija i postiže dogovor o planu rada i rokove sa rukovodiocem i drugim stručnim kadrovaima za planiranje budžeta;

☒ Učestvuje u izradi godišnjih budžetskih planova institucija, i pomaže odgovarajuće zvaničnike unitar institucije da bi osigurao da se planovi kompletiraju precizno i prema roku;

☒ Vodi računa da prati stanje budžeta u free balancu, praćenje budžetskih izdataka tokom godine i priprema izvještaje u pogledu potrosnje budžeta;

• Identifikuje račune za plaćanje projekata i plaćanja u odgovarajući registar i stara se da proces bude izvršen na vreme za izvršenje plaćanja.

• Prikuplja i raspolaze predlozima budžeta i u saradnji sa višim zvaničnikom razmatra ispravnost, i tačnost predloga;

• Stara se za ispunjavanje obaveza prema budžetskoj organizaciji, uključujući i blagovremeno plaćanje računa za sprovođenje postupka nabavke i plaćanja;

• Vodi evidenciju o slučajevima za plaćanje službenih putovanja van zemlje - za avans službenih putovanja;

• Obavlja i druge poslove u skladu sa zakonima i propisima koji se razumno zahtevaju svremena na vreme od strane nadležnog;

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim / Uslovi za učešće na regrutaciji/

1. Në Shërbimin Civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë të veprojshme, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimit e funksioneve administrative, si dhe kanë aftësitë fizike, që kërkojnë për pozitën përkatëse. /

1. U Civilnoj službi ima pravo zaposlenja državljani Republike Kosovo punoletni koji imaju punu sposobnost obavljanja poslova, koji su u posedovanju civilnih i političkih prava, koji imaju potrebnu školsku spremu i stručnu sposobnost za obavljanje zadataka u ekzekutivu, upravljanju ili sprovođenju administrativnih funkcija, oni koji imaju psiho-fizičku sposobnost koja su potrebna za obavljanje dotičnih zadataka.

2. Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës mund të bëhet deri në një (1) vit para moshës së pensionimit. /

2. Prijem u Civilnoj službi Kosova može se izvršiti do jedne (1) godine pre penzionisanja.

Procedurat e konkurrimit / Postupak konkurisanja/

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët të jashtëm dhe për nëpunës civilë ekzistues / Procedura konkurisanja je otvorena za spoljne kandidate kao i za postojeće civilne službenike

Shkollimi i kërkuar / Obrazovanje koji se zahteva/

- Diplome Universitare-Menaxhment, Marketing, Banka Financa dhe Kontabilitet, pa përvojë ose shkollë të lartë dhe së paku dy(2) vite përvojë pune;

- Univerzitetska diploma-Menadžment, marketing, bankarske finansije i računovodstvo, bez iskustva ili visokog obrazovanja i najmanje dve (2) godine radnog iskustva;

Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkojnë / Veštine, iskustvo i druge osobine koje se zahtevaju.

- Diplome Universitare-Menaxhment, Marketing, Banka Financa dhe Kontabilitet, pa përvojë ose shkollë të lartë dhe së paku dy(2) vite përvojë pune;
- Njohuri profesionale në fushën e administratës;
- Shkathtësi për të organizuar punën e vet dhe për të koordinuar stafin e nivelit administrativ; Shkathtësi hulumtuuese, analitike, vlerësuese të informacionit, aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit)

- Univerzitetska diploma-Menadžment, marketing, bankarske finansije i računovodstvo, bez iskustva ili visokog obrazovanja i najmanje dve (2) godine radnog iskustva;

- Stručna znanja u oblasti uprave;
- Veština u organizovanju svog rada i koordinacija osoblja na administrativnom nivou;
- Istraživačke, analitičke i veštine vrednovanja informacija, sposobnost za obavljanje zadataka i rad pod pritiskom; Kompjuterski softverski programi (Word, Excel, Power Point, Internet);

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin / Zakonski i podzakonski akti koji regulišu zapošljavanje: Përzgjedhja bëhet në pajtim me Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil. / Izbor se vrši u skladu sa Zakonom br.03/L-149 o Civilne Službe Republike Kosova, Pravilnika br.02/2010 o procedurama regrutacije u Civilnoj Službi.

Kohëzgjatja e emërimit / Vremenski rok imenovanja: Me afat të pacaktuar - e përhershme (e karrierës) / Na neodređeno vreme - stalna (karijere)

Afati i konkursit / rok konkursa Afati i konkursit është 15 ditë kalendarike, nga data e publikimit në mjetet e informimit publik/Rok za konkurs je 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja u javnim infomrativnim sredstvima.

Data e mbylljes së konkursit / Krajni rok konkursa: 17 gusht/avgust 2019

Paraqitja e kërkesave / Prijava zahteva-Podnošenje zahtevi: /

Aplikacionet merren dhe dorëzohen / Aplikacija se uzima i dostavlja:

Rr."Zenel Salihu", objekti i ish-Gjykatës Themelore të Prishtinës, kati i II-të, zyra nr. 204, Divizioni për Burime Njerëzore, Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale ose mund të shkarkohen në ueb-faqen <https://amkmk.rks-gov.net>, Ul. "Zenel Salihu", bivša zgrada Osnovnog Suda u Pristini, sprat II, kancelarija br.204, Odsek za Ljudske Resurse, Agencija sa Upravljanje Memorialni Kompleksa Kosova ili se može preuzeti sa ueb-stranice <https://amkmk.rks-gov.net>

Kërkesat specifike/Specifični zahtevi: Nuk ka/Ne

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit:

1. Dëshminë e kualifikimit shkollor (diplomat jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i);
